



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

RAPORT KONSULTIMI
PËR
DRAFT KONCEPT DOKUMENTIN PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT TË
VETINGUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Tetor 2021

Hyrje

Draft Koncept Dokumentin për Zhvillimin e Procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë është nisma e parë strategjike dhe gjithëpërfshirëse për planifikimin e politikave për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë. Ky Koncept Dokument është hartuar në bashkëpunim dhe koordinim të plotë në mes të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial, si dhe institucioneve tjera në këtë sektor, por edhe në partneritet dhe konsultim me shoqërinë civile dhe donatorët ndërkombëtar.

Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, përmes vetingut dhe mekanizmave tjerë. Si objektivë operationale është zhvillimi i kornizës juridike për fillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë.

Koncept Dokumenti është i strukturuar në shtatë kapituj, ku përfshihen edhe planet e zbatimit për secilin nga opsionet e propozuara, si dhe analiza e ndikimeve të ndryshme të zbatimit të politikës.

Për sa i përket opsioneve, Koncept Dokumenti trajton pesë opsione kryesore lidhur me nevojën për zhvillimin e vetingut për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, si dhe nëpunësit në pozita të larta në sistemin e drejtësisë. Opsioni 1 trajton zbatimin e politikës pa asnjë ndryshim i cili parasheh ruajtjen e status quo; Opsioni 2 trajton zbatimin e politikës përmes përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjor, e që shtynë përpara idenë se gjendja aktuale mund të ndryshohet mjaftueshëm vetëm me implementim më të mirë të kornizës ekzistuese ligjore; Opsioni 3 parashet zhvillimi i vetingut përmes ndryshimeve ligjore, kjo qoftë me ligje të reja apo amendamentim të atyre ekzistuese; Opsioni 4 modelon zhvillimin e vetingu ad hoc dhe pastaj vlerësimin të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë nga një mekanizëm i jashtëm përmes ndryshimeve kushtetuese; dhe Opsioni 5 parasheh zbatimin e procesit të vetingut me ndryshime kushtetuese që mundëson vetingun nga një trup ad-hoc dhe më pas vijimin e vlerësimin të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë nga KGjK dhe KPK.

Ecuria procesit të konsultimit

Draft Koncept Dokumentin për Zhvillimin e Procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë është publikuar për konsultim me publikun në platformën elektronike për konsultimet publike me datë 29.07.2021. Koncept Dokumenti ka qenë i hapur për konsultime deri me datë 19.08.2021.

Gjatë procesit të konsultimit janë pranuar gjithsej 74 komente nga institucionet/organizatat si në vijim:

- Komisioni Evropian (DG NEAR dhe DG JUST) dhe Zyra e BE-së në Kosovë;
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS);
- Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD);
- OSCE.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	15 ditë	Kontribues - 7
2. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	15 ditë	Kontribues - 4
3. Takimet publike	1	

Përmbledhje e kontributeve të pranura gjatë procesit të konsultimit

Në procesin e konsultimit publik janë dërguar komente të natyrës së ndryshme, përfshirë komente të përgjithshme, si dhe komente specifike për sa i përket opsioneve. Në total dërguar gjithsej 74 komente.

Nga këto komente:

- 28 komente janë **pranuar plotësisht** (38%).
- 34 komente janë **pranuar pjesërisht** (46%).
- 12 komente janë **refuzuar** (16%).

Hapat e ardhshëm

Draft Koncept Dokumentin për Zhvillimin e Procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë është finalizuar dhe është miratuar në Qeveri.

Shtojca - Tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Për shkak të numrit të madh të komenteve, shtojca është e bashkëngjitur në formatin *excel*.

Emri i organizates/individit	Kapitulli përkatës në Koncept Dokument	Komenti	Përgjigja nga Ministria: Pranohet plotësisht/ pranohet pjesërisht/ refuzohet	Sqarimi nga Ministria
EU	Koment i përgjithshëm	Lidhur me draftin e KD, do ta përsërisnim rekomandimin tonë që të bëhet një analizë lidhur me arsyet përse mekanizmat aktualë nuk janë efektivë në mënyrë të mjaftueshme dhe si mund të përmirësohen ata, përfshirë përmes ndryshimeve të reja legjislative për zbatim më të mirë. Përmirësimi i mekanizmave ekzistues, përfshirë ndryshimet legjislative dhe zbatimin më të mirë, duhet të hulumtohen tërësisht së pari para se të fillojnë proceset e reja.	Pranohet pjesërisht	<p>Pas komenteve të pranuar përgjatë konsultimeve publike, Grupi Punues e ka zgjeruar analizën sa i përket përmirësimit të mekanizmave aktualë përmes ndryshimeve ligjore, përkatësisht përparësive dhe mangësive të Opsionit 2. Megjithatë, është arritur prap përfundimi se investimet e vetme në buxhet dhe ngritje të kapaciteteve nuk do të mund të adresojnë problemin kryesor të punës së mekanizmave aktualë. Ky problem është mungesa e bazës së mjaftueshme ligjore e rregullative në të cilën do të sqaroheshin kompetencat dhe autorizimet e tyre si dhe baza tejet e ngushtë e të dhënave që mblidhen për kandidatët. Por, më e rëndësishmja, këtyre njësive ju mungon autorizimi ligjor e rregullativ për të bërë këtë punë në baza të rregullta.</p> <p>Shtuar kësaj që pa një rregullativë ligjore të re, edhe nëpunësit në pozita të larta brenda sistemit të drejtësisë, e të cilët kanë rol të theksuar në funksionimin adekuat të</p>

			<p>sistemit, mbesin të pavetuar. Sa i përket pozitive të administratës së gjyqësorit që bien në fushëveprimin e këtij Koncept Dokumenti, sipas Aktgjykimi nr. KO203/19, Gjykata Kushtetuese, ka konstatuar se Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me këto pozita. Rrjedhimisht, edhe çështja e rekrutimit dhe disiplinës të këtyre pozitive mbetet e parregulluar, meqenëse nuk gjejnë zbatim as dispozitat e as rregullorja përkatëse e ligjit të përmendur.</p> <p>Gjithashtu, Opsioni 2 është kundërshtuar zëshëm edhe nga komentet e pranuar nga organizatat e shoqërisë civile përgjatë konsultimeve publike. Organizatat e shoqërisë civile janë shprehur shumë kritikë ndaj mekanizmave ekzistues, duke përmendur se pavarësisht faktit se me legjislacionin në fuqi, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial kanë mundësi që të përshtatin zbatimin e detyrave të tyre, përmes miratimit të akteve nënligjore, vullneti për një gjë të tillë në rastin e njësie për verifikim ka munguar.</p> <p>Si rrjedhojë, edhe pas</p>
--	--	--	---

				<p>thellimit të analizës në Opsionin 2, përmes këtij opsioni është e pamundur të adresohen plotësisht dhe substancialisht problemet e identifikuar në këtë Koncept Dokument. Rrjedhimisht, ky opsion mundëson vetëm harnimin sipërfaqësor të mekanizmave ekzistues, pa ofruar mundësi për ndryshim real. Në një farë mënyrë, ky opsion do të ishte efektiv, për shkak të kostos më të ulët në krahasim me opsionet 3, 4 dhe 5, mirëpo efektiviteti i tij do të ishte i papërfillshëm, në raport me opsionet e tjera dhe qëllimet e kësaj politike.</p>
--	--	--	--	--

EU	Koment i përgjithshëm	<p>KD është kryesisht një "dokument historik shkencor/hulumtues dhe nuk arrin ta vërtetojë, në mënyrë konkrete, duke u bazuar në standardet evropiane, domosdoshmërinë e vetingut si zgjidhje të fundit të masës së reformës në rastin specifik të Kosovës. Ndonëse dokumenti i referohet shembullit të vetingut në vendet e tjera, ai nuk arrin të tregojë në mënyrë të suksesshme që në këtë rast janë plotësuar parakushtet kryesore për veting. KD nuk duhet të bëhet një dokument më operacional që i përcakton opsionet e ndryshme në hollësi së bashku me planin e kostos.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Analiza e gjendjes faktike e shtjelluar në kapitullin "Problemi kryesor", identifikon si problem kryesor profesionalizmi dhe integriteti i gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve civil në pozita të larta në sistemin e drejtësisë. Ky problem serioz dhe kronik është identifikuar në vazhdimësi gjithashtu edhe nga raportet ndërkombëtare, përfshirë Raportet e Vendit të KE-së dhe gjithashtu, nga një sërë raportesh të shoqërisë civile. Këto raporte argumentojnë gjendjen alarmante në sistemin e drejtësisë, e që si e tillë, nuk ka mundur të adresohet me mekanizma të rregullt.</p> <p>Analiza e zhvilluar vjen në përfundim se shkaqe të këtij problemi janë mangësitë ligjore dhe zbatimi jo adekuar i legjislacionit në fuqi. Sipas kësaj analize të detajuar, janë identifikuar po ashtu tri efekte kryesore: humbja e besimit të qytetarëve në drejtësi, shkelja e të drejtave të njeriut dhe ndikimi negativ edhe në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës.</p> <p>Pikërisht duke u shërbyer me praktikën e vendeve tjera dhe standardet ndërkombëtare të</p>
----	-----------------------	---	---------------------	--

			<p>trajtuar në Koncept Dokument, është arritur te përfundimi se arritja e qëllimit - e që është rritja e integritetit të sistemit të drejtësisë dhe kthimi i besimit qytetar në sistemin e drejtësisë, arrihet vetëm e vetëm përmes zhvillimit të vetingut dhe vlerësimit vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë . Sic shtjellohet në Opsionin 1 dhe 2, përvoja ka dëshmuar se çfarëdo përpjekje tjetër ndër vite, ka dështuar të ofrojë zgjidhje të plotë dhe ka ofruar rezultate të pakënaqshme, gjysmake dhe jo të qëndrueshme. Prandaj, vetingu dhe vlerësimi i vazhdueshëm i frymëzuar nga vetingu është vlerësuar të jetë mënyra e vetme për arritjen e rezultateve të plota dhe të qëndrueshme.</p> <p>Sa i përket cilësimit të dokumentit si dokument historik shkencor/hulumtues, arritja e objektivave të paraqitura në këtë Koncept Dokument është operacionalizuar përmes detajimit në Planet e Zbatimit dhe kostimit për secilin nga opsionet.</p>
--	--	--	--

EU	Opsioni 2	<p>Dokumentit i mungon analiza përse mekanizmat aktualë (deklarimi i pasurisë, procedurat disiplinore dhe vlerësimet) nuk po funksionojnë dhe mënyra si munden të reformohen/përmirësohen këto mjete ekzistuese përmes masave legislative. Kjo mund të bëhet në opsionin 2, i cili aktualisht është vetëm duke e shqyrtuar mënyrën e zbatimit më të mirë të legjislacionit ekzistues.</p>	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 2.
EU	Opsioni 3	<p>Opsioni 3 nuk duket të jetë i realizueshëm, meqë është praktikisht e pamundur (d.m.th paraqet konflikt të interesit) që anëtarët e KGJK/KPL të verifikohen nga KGJK/KPK. Kjo nuk mund të kundërshtohet nga masat mbrojtëse të propozuara, meqë edhe anëtarët e organeve të “decentralizuara” do të zgjidheshin nga Këshillat. Përderisa asnjë organ tjetër nuk ka ndikim vendimtar në këtë proces, ky opsion do të ishte i kotë. Megjithatë, të gjitha konsideratat lidhur me mënyrën e reformës/ndryshimit të strukturave dhe të organeve ekzistuese (AKK, Këshillat) do të përshtateshin në mënyrë</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Pas komenteve nga konsultimi publik, Opsioni 3 është ndryshuar ashtu që është larguar në tërësi Nënopsioni 1 që parashihte sistemin të decentralizuar.</p> <p>Duhet të theksohet se analiza e zhvilluar në Opsionin 3, parasheh zhvillimin e vetingut dhe vlerësimin të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë në përputhje me kornizat dhe rrjedhimisht kufizimet që i përcakton Kushtetuta. Si rrjedhojë, është e pamundur që çfarëdo ndërhyrje vetëm përmes ndryshimit të legjislacionit, të anashkalojë kompetencat kushtetuese të Këshillave. Sistemi është modeluar në</p>

		të përsosur në opsionin e ri 2, i cili do ta shqyrtonte mënyrën e përmirësimit të mekanizmave ekzistues.		frymën e ndarjes së pushteteve që përcakton Kushtetuta. Vendimmarrja përfundimtare ju është lënë këtyre organeve, pikërisht për shkak të përcaktimeve kushtetuese.
EU	Koment i përgjithshëm	Ndërmjet opsionit 3, 4 dhe 5, vetëm opsioni 4 thekson që do të nevojiteshin ndryshime kushtetuese në mënyrë që të zhvillohet një mekanizëm efektiv i vetingut. Një reformë e tillë thelbësore e gjyqësorit duhet të bazohen në dispozitat e qarta kushtetuese në këtë aspekt. Nëse pjesa dërrmuese e Parlamentit nuk i mbështet ndryshimet kushtetuese, fokusi duhet të jetë në opsionet e tjera e jo në procesin e njëhershëm, p.sh. në reformimin e mekanizmave ekzistues/opsioni 2.	Refuzohet	Ky koment refuzohet për shkak se është jashtë fushëveprimit të këtij Koncept Dokumenti, meqenëse nuk përkon me qëllimin e një koncept dokumenti, e që është t'i mundësojë Qeverisë shqyrtimin e përgjithshëm të objektivave dhe karakteristikave kryesore të një propozimi si dhe opsioneve të ndryshme për zgjidhjen e çështjes përkatëse.
EU	Koment i përgjithshëm	Do t'ia vlente të kufizohej fushëveprimi i vetingut vetëm në institucionet kryesore gjyqësore (GJK, GJS, KGJK/KPKC) meqë ato janë institucionet kryesore për zbatimin e mjeteve ekzistuese (deklarimin e	Refuzohet	Në procesin e vetingut është paraparë të kalojnë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Po ashtu, vetingut do t'i nënshtrohen edhe një kategori e zyrtarëve në pozita të larta drejtuese brenda sistemit, si: administratorët e gjykatave, të prokurorive

pasurisë, procedurat disiplinore dhe vlerësimin).

edhe Drejtorëve të Sekretariateve të KGJK/KPK, si dhe Drejtori i Njesisë për Inspektim Gjyqësor. Të njëjtat profile do t'i nënshtrohen më pas dhe rregullisht edhe vlerësimit të vazhdueshëm. Duke pasur në mendje përkufizimin e Problemit kryesor, përzgjedhja e pikërisht këtyre profileve është bërë për shkak të kompetencave dhe shkallës së ndikimit real që kanë në sistemin e drejtësisë.

EU	Koment i përgjithshëm	<p>Çdo mekanizëm i vetingut ashtu siç përshkruhet në opsionin 3, 4 dhe 5 duhet t'i përfshijë institucionet më të larta gjyqësore, përfshirë Gjykatën Kushtetuese. Në të vërtetë, puna duhet të fillojë madje me Gjykatën Kushtetuese (dhe me institucionet e tjera kryesore gjyqësore). Duke u bazuar në përvojën e vendeve të tjera, vetingu pa përfshirjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese do ta rrezikonte krejt procesin e reformës.</p>	Refuzohet	<p>Sipas këtij Koncept Dokumenti, vetingu në sistemin e drejtësisë nuk ka përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese për faktin se në Gjykatën Kushtetuese nuk identifikohen problemi kryesor, shkaqet dhe efektet, sikurse në gjykatat e rregullta dhe prokuroritë. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Ajo siguron funksionalitetin e institucioneve të vendit në pajtim me Kushtetutën dhe garanton mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive individuale të garantuara me Kushtetutë. Përderisa gjykatat e rregullta merren me shqyrtimin e fakteve, me verifikimin e ligjshmërisë së krijimit dhe të marrjes së provave, Gjykata Kushtetuese merret vetëm me kontrollin kushtetues të procesit të rregullt gjyqësor.</p> <p>Sistemi i drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese janë të ndarë në kapituj të veçantë në Kushtetutë, ku sistemi i drejtësisë përfshinë Gjykatat e rregullta, Prokurorinë, Këshillat (KGJK dhe KPK) dhe Avokatinë, ndërsa Gjykata</p>
----	-----------------------	---	-----------	--

			<p>Kushtetuese ka një përbërje, mandat dhe rregullim tjetër.</p> <p>Tutje, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi, për dallim nga mandati i përhershëm i gjyqtarëve të gjykatave të rregullta dhe prokurorëve. Kombinuar me sistemin e rotacionit të mandateve, kjo do të thotë se në këtë gjykatë ka rregullisht ripërtëritje në përbërje në mesin e gjyqtarëve, e cila dallon nga gjykatat dhe prokuroritë e rregullta. Për më tepër, në kuptim të organizimit institucional dhe funksional të gjyqësorit, Gjykata Kushtetuese përbën entitet krejt të veçantë. Në këtë kontekst, vlen të theksohet sidomos procesi i emërimit dhe propozimit nga Kuvendi i gjyqtarëve të kësaj gjykate.</p> <p>Vettingu për Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të nënkuptonte ndryshime të thella në Kushtetutë apo suspendim të neneve kushtetuese që flasin për përbërjen, mandatin, pavarësinë dhe organizimin e saj rezultati i të cilave nuk do të ishte përmirësimi i Gjykatës Kushtetuese, por bllokim i saj. Fakti që mandati</p>
--	--	--	--

				<p>i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është i kufizuar në nëntë vite dhe pa të drejtë rizgjedhje si dhe kohëzgjatje e ndryshme për gjyqtarët e kësaj gjykate janë një mundësi që përmes Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të parashihet një vetting para se ata të votohen nga Kuvendi i Kosovës.</p> <p>Për më tepër, planifikohet që në Koncept Dokumentin për Gjykatën Kushtetuese që është paraparë të hartohet gjatë mandatit qeverisës, të adresohet çështja e nevojës për verifikim të gjyqtarëve kushtetues. Përderisa raportet ndërkombëtare kanë qenë vazhdimisht të zëshme për sa i përket performancës dhe profesionalizmit të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta dhe prokurorëve, nuk evidentohen raporte të kenë kritikuar profesionalizmin dhe integritetin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e këtij Koncept Dokumenti.</p>
EU	Koment i përgjithshëm	Përveç kësaj, duhet të shqyrtohet sërish, nëse kontrollimi i kompetencave vërtetë nevojitet, meqë kjo	Refuzohet	Duke u shërbyer nga praktikat e vendeve tjera dhe standardeve ndërkombëtare, Grupi Punues ka ardhur në përfundimin që vlerësimi i

		përbën punë të rëndësishme shtesë.		profesionalitetit përbën një nga segmentet kyce të vlerësimit të përshtatshmërisë së figurës së subjektit të vetingut.
GLPS	Koment i përgjithshëm	Fillimisht, në mënyrë që vetingu të jetë një reformë e thellë e këtij sektori, të njejtës duhet të i nënshtohen jo vetëm gjyqtarët dhe prokurorët dhe stafi administrativ por edhe institucione të tjera. Një gjë e tillë është diskutuar disa herë dhe qëndrimi i GLPS-së është i atillë që kësaj reforme duhet të u nënshtrohen edhe të gjithë zyrtarët në Gjykatën Kushtetuese, ATK, Dogana, AKI, Polici. Dhe për të u realizuar një reform e tillë, ndryshimet kushtetuese janë të pashmangshme.	Refuzohet	Përderisa një koment i tillë është shumë i vlefshëm, konsiderojmë se përgjigja nuk mund t'i jepet në këtë koncept dokument, meqenëse bie jashtë fushëveprimit të tij.
GLPS	Opsioni 4	Tek pjesa që trajton ndryshimin e neneve kushtetuese në koncept dokument, GLPS rekomandon që kompetenca e presidentit për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të bartet tek mekanizmi i vetingut. GLPS propozon që të ndryshohet neni 84 i Kushtetutës i cili parashesh kompetencat e Presidentit, ashtuqë kompetenca e shkarkimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kaloj nga Presidenti tek mekanizmi i vetingut, ndërsa theksi të bie	Refuzohet	Ky model është paraparë në frymën e ndarjes së pushteteve dhe kompetencave tipike përkatëse të secilit institucion për një demokraci parlamentare, sic është Kosova. Sipas Opsionit 4, duhet plotësuar nenet 104 (1) dhe 109 (7) që rregullojnë propozimin për emërim dhe shkarkim, si dhe nenin 84 për kompetencat e Presidentit, gjegjësisht paragrafi (15), (16), (17) dhe (18), në

		<p>që Presidenti vetëm të njoftohet për shkarkimin e tyre.</p> <p>Pra, në rastet kur subjekti i vetingut nuk e kalon verifikimin, gjyqtari dhe prokurori të shkarkohen me ndodhjen e faktit të moskalimit me sukses të këtij procesi dhe me njoftimin e presidentit.</p>		<p>mënyrë që kompetenca e propozimit për emërim/shkarkim t'i dorëzohet mekanizmit të pavarur për periudhën e vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë. Ky propozim i drejtohet Presidentit, i cili pastaj do ketë të drejtën për shkarkim të subjektit përkatës.</p> <p>Pra, duhet të rregullohen kompetencat e Presidentit për emërim, riemërim dhe shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto kompetenca duhet të jenë kryesisht formale, por të krijojnë siguri dhe legjitimitet të procesit të vetingut. Pra, shkarkimi i subjektit vendoset në bashkëpunim në mes të mekanizmit dhe Presidentit, për të siguruar po ashtu kontrollin dhe balancin e procesit</p>
GLPS	Opsioni 4	<p>Së dyti, tek po kjo pjesë (ndryshimi i neneve kushtetuese) GLPS rekomandon që me dispozitën e re kushtetuese me të cilën do të parashihet mekanizmi i veçantë për veting, të parashihet edhe fushëveprimi dhe kompetencat e këtij mekanizmi, kjo gjithmonë</p>	Pranohet plotësisht	

		duke pasur parasysh pasojat juridike që do të ketë ky mekanizëm.		
GLPS	Opsioni 4	<p>GLPS propozon që ndër pjesët tjera të kësaj dispozite, si dispozita eksplicite të parashihene dhe dispozitat si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Autorizimi kushtetues për krijimin dhe përbërjen një mekanizmi të vazhdueshëm që do të jetë bartës i procesit të vetingut; 2. Autorizimi kushtetues për të kryer vetingun ndaj subjekteve të vetingut duke përfshirë edhe autoritetin për të bërë shkarkimin e një subjekti që nuk kalon procesin e vetingut; 3. Klauzola për përfundimin e përhershmerisë së mandatit të gjyqtarit dhe prokurorit dhe subjekteve të tjera që kanë mandat të përhershëm. 4. Përcaktimin e subjekteve të vetingut duke mos u kufizuar vetëm në gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtar dhe prokuror por edhe duke lënë mundësinë që me ligj të përcaktohen edhe kategoritë e personave të tjerë zyrtar që vlerësohen se duhet të kalojnë procesin e vetingut. 5. Kriteret mbi të cilat do të kryhet vetingu duke 	Pranohet pjesërisht	Secila nga çështjet ngritura është shtjelluar në detaje në Koncept Dokument.

		<p>përfshirë: vlerësimin e integritetit, profesionalizmit dhe pasurisë. Pesha e secilit kriter duhet të përcaktohet me ligj.</p> <p>6. Mekanizmi ankimor dhe juridiksioni i plotë për të vendosur mbi ankesat e subjekteve të vetingut.</p>		
GLPS	Opsioni 4	<p>Tek pjesa që trajton procedurën e vetingut në koncept dokument, GLPS rekomandon që gjatë procesit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinjë, njëkohësisht edhe nëpunësit në pozita të larta, të njejtit para fazës së emërimit të i nënshtrohen procesit të vetingut. Dhe vetëm nëse ky proces kalohet, të vazhdohet me procedurat e emërimit.</p>	Pranohet plotësisht	<p>Në rastet kur shpallet konkursi për rekrutim në pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit, kandidati do të kalojë fillimisht procesin e vetingut nga Mekanizmi. Vetëm pas kalimit të vetingut nga ana e Mekanizmit, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë do t'i propozohen Këshillit për të bërë rekrutimin e tyre e në vijim për emërim nga Presidenti. Në qoftë se kandidati vlerësohet negativisht nga mekanizmi, atëherë ai nuk mund të vijojë procesin e rekrutimit. E njëjta do të vlejë edhe për nëpunësit në pozita të larta drejtuese. Për më</p>

				<p>tepër, shih kapitullin me Planin e zbatimit.</p> <p>Mbledhja e raporteve, procesi i vlerësimit, propozimi i sanksionit si dhe procedura e vetingut në fazën e rekrutimit do të përcaktohen me ligj.</p>
GLPS	Opsioni 4	<p>Tek pjesa që trajton organet kompetente për zhvillimin e vetingut në koncept dokument, GLPS rekomandon që mekanizmi i vetingut të përmbajë dy nivele:</p> <p>I. Nivelin e parë: Mekanizmi i verifikimit të fakteve , të përbërë nga avokatë të shquar lokalë, gjyqtarë dhe prokurorë, i cili do të shërbente si mekanizmi i shkallës së parë për të rishikuar përputhshmërinë e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe do të shërbente si shkalla e vetme që gjykon aspektet faktike në lidhje me figurën e gjyqtarëve dhe prokurorëve;</p> <p>II. Nivelin e dytë: Mekanizmin ndërkombëtar që do të monitoronte dhe do të shërbente si instancë përfundimtare e apelimit në rastet kur janë shkelur masat mbrojtëse procedurale.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Mekanizmi në tërësi parashihet të përbëhet nga:</p> <p>a) Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut gjegjësisht vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë (shkalla e parë);</p> <p>b) Sekretariati dhe njesitë hetuese; dhe c) Kolegji për Apelim (shkalla e dytë).</p> <p>a) Mekanizmi për zhvillimin e procesit të vetingut dhe për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë</p> <p>Fillimisht parashihet themelimi i Mekanizmit të Vetingut i cili do të jetë një mekanizëm i pavarur i përbërë nga pesë panele, tre për gjyqtarë dhe dy për prokurorë. Panelet për gjyqtarë do të përbëhen nga tre anëtar, dy gjyqtarë dhe një anëtar jo gjyqtar. Panelet për prokurorë do të përbëhen nga tre anëtar, dy prokurorë dhe një anëtar jo prokuror. Mekanizmi do të ketë kryesuesin i cili do të</p>

			<p>zgjidhet me rotacion nga radhët e anëtarëve gjyqtarë apo prokurorë të paneleve.</p> <p>Pas përfundimit të vetingut të të gjithë subjekteve ky mekanizëm do të ristrukturohet në Mekanizëm për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë. Rrjedhimisht panelet do të ristrukturohen dhe numri i paneleve dhe numri i përgjithshëm i anëtarëve do të reduktohet varësisht nga vlerësimi i nevojave në përfundim të kësaj faze.</p> <p>Numri i paneleve dhe antarëve të tyre mund të ndryshohet dhe përshtatet varësisht nga nevojat të cilat mund të shfaqen gjatë hartimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore.</p> <p>b) Sekretariati Në përbërjen e Mekanizmit do të parashihet Sekretariati, i cili ofron gjithë mbështetjen administrative dhe logjistike për panelet. Në përbërjen e Sekretariatit do të jenë tre njësi : a) Njësia për aftësi profesionale dhe performancë; b) Njësia për pasuri dhe; c) Njësia për integritet. Secila nga këto</p>
--	--	--	--

			<p>njësi do të ketë nga 25 hetues profesionalë dhe 5 anëtarë të stafit administrativ. Këto njësi do të mbledhin dhe përpunojnë informacionet përkatëse për secilin subjekt të vetingut të cilat i dërgohen paneleve për shqyrtim dhe vendosje. Të gjithë anëtarët e këtij organi do t'i nënshtrohen paraprakisht vetingut.</p> <p>c) Kolegji për Apelim Në përbërjen e Mekanizmit, parashihet që të jetë edhe Kolegji për Apelim i cili do të përbëhet nga pesë gjyqtarë. Anëtarët e këtij mekanizmi do të vetohen paraprakisht nga një organ i jashtëm me prezencë ndërkombëtare dhe do të monitorohen për punën e tyre vazhdimisht. Me fillimin e fazës së ristrukturimit të Mekanizmit dhe reduktimin e stafit, Kolegji i Apelimit do të shuhet dhe kompetencat për shqyrtimin e ankesave të subjekteve të vetingut do të kalojnë në Gjykatën Supreme</p>
--	--	--	--

GLPS	Opsioni 4	<p>b. Ligji i cili konkretizon amandamentin kushtetues duhet të përcaktojë që anëtarët e mekanizmit ndërkombëtraë të jenë avokatë ndërkombëtarë që shërbejnë si kohë të plotë në pozita të larta me KE, SH.B.A., Gjermania ose shtetet e tjera të konsoliduara dhe se ata nuk kanë formim diplomatik ose politik. Synohet që ata të jenë gjyqtarë ose prokurorë në detyrë, ose zyrtarë të lartë të integritetit në sektorin e drejtësisë në vendin e tyre. Në anën tjetër, ligji duhet të përcaktojë që anëtarët e mekanizmit të verifikimit të jenë avokatë të dalluar të Kosovës, gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët gjithashtu kalojnë verifikimin paraprak në sfondin e tyre nga Mekanizmi i Nivelit të Dytë, dhe të cilët janë të pakontestueshëm për sa i përket integritetit, pozitës profesionale, pastërtisë së pasurisë dhe pavarësia nga qarqet partizane ose kriminale. Anëtarët e Nivelit Një duhet të jenë gjithashtu figura që janë përkushtuar të veprojnë me guxim kundër anëtarëve ekzistues të sektorit të drejtësisë dhe që do të gëzojnë monitorim të plotë nga Niveli Dy në lidhje</p>	Refuzohet	<p>Procedura përmes së cilës parashihet të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të mekanizmave, ndonëse do të niset me konkurs dhe përfundohet nga vetë Këshillat, do të ketë përfshirje të madhe të mekanizmave gjegjëse ndërkombëtarë. Këshillat do të mund të kontraktojnë apo të bëjnë marrëveshje mirëkuptimi me trupa apo organizata ndërkombëtare për të kërkuar ndihmën e tyre në përzgjedhjen, përfshirë vlerifikimin, e anëtarëve të mekanizmave respektiv. Një model i ngjashëm me këtë mund të shihet aktualisht në Kosovë në modalitetet e gjetura për përzgjedhjen e Pozitave të Larta Drejtuese, procedura këto në të cilat intervistimi dhe rekomandimi vie nga trupa me përbërje ndërkombëtare (shembull me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë). Pjesëmarrje monitorues do të kërkohet nga partnerët ndërkombëtarë edhe përgjatë gjithë periudhës sa zgjatë vetingu.</p>
------	-----------	--	-----------	--

		me pajtueshmërinë e tyre me rregullat e Zyrës.		
GLPS	Opsioni 4	c. Mekanizmi i vetingut duhet të parashikojë krijimin e një makinerie për mbledhjen e informacionit që mund të përpunojë informacion të besueshëm, veçanërisht mbi aspektet që lidhen me afërsinë e gjyqtarit ose prokurorit me qarqet kriminale ose partizane. Mund të konsiderohet të përdoren të dhëna të inteligjencës që normalisht konsiderohen si të dhëna të mbrojtura nga ligjet e privatësisë. Një shmangie e tillë nga legjislacioni i privatësisë është absolutisht legjitim dhe ligjor - siç kishte konkluduar edhe Komisioni i Venecias në rastin e Shqipërisë - sepse ai ka një	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 15. Në përbërjen e Mekanizmit do të parashihet Sekretariati, i cili ofron gjithë mbështetjen administrative dhe logjistike për panelet. Në përbërjen e Sekretariatit do të jenë tre njësi : a) Njësia për aftësi profesionale dhe performancë; b) Njësia për pasuri dhe; c) Njësia për integritet. Secila nga këto njësi do të ketë nga 25 hetues profesionalë dhe 5 anëtarë të stafit administrativ. Këto njësi do të mbledhin dhe përpunojnë informacionet përkatëse për secilin subjekt të vetingut të cilat i dërgohen paneleve për shqyrtim dhe vendosje. Të gjithë anëtarët e këtij organi

		qëllim proporcional dhe i shërben interesit publik;		do t'i nënshtrohen paraprakisht vetingut.
GLPS	Opsioni 4	d. Mekanizmi i vetingut duhet gjithashtu të parashikojë që megjithëse një gjyqtar ose prokuror mund të jetë gjykuar një herë për një veprim ose mosveprim të caktuar disiplinor, natyra përfundimtare e vendimit të autoritetit kompetent nuk do të konsiderohet e rëndësishme kur shqyrtohet figura e tij / saj nën procesi i vetingut. Kjo shmangie nga parimi kryesor i res judicata është absolutisht i lejueshëm duke marrë parasysh që procesi i verifikimit ka për qëllim vlerësimin e tërësisë së të kaluarës dhe nuk mund të bazohet në vlerësimet e mëparshme, besueshmëria e të cilave nuk ishte e siguruar.	Refuzohet	Është mbuluar mjaftushëm në koncept dokument.

GLPS	Opsioni 4	<p>i. a) Integritetin etik të atyre që i nënshtrohen vetingut; Integriteti në këtë drejtim ka për qëllim të mbulojë aspekte në lidhje me rregullat etike të sjelljes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në vitet e fundit, me një prag minimal prej 10 vjetësh. Integriteti në këtë drejtim do të kuptohet jo vetëm si pajtueshmëri me rregullat në lidhje me figurën morale të gjyqtarit dhe prokurorit, por edhe pajtueshmëri me legjislacionin që rregullon sjelljen e gjyqtarëve, siç janë ligjet për KGJK, KPK, ligjet për gjyqësorin, klauzolat për konfliktin e interesit të ligjeve procedurale, ligjeve në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe prokurorit, duke përfshirë ato që rregullojnë shpërblimin, privilegjet, transparencën e të ardhurave, transparencën e lidhjeve me palët që i nënshtrohen juridiksionit të Zyrës, etj. Komponenti i integritetit të vetingut do të përfshinte një numër të madh të standardeve dhe respektimin e tyre nga gjykatësi ose prokurori.</p> <p>ii. b) Profesionalizmi i atyre që i nënshtrohen vetingut; Profesionalizmi në këtë drejtim përfshin dy komponentë, një, njohuritë e</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Me dispozita përkatëse do të përcaktohen tri kategori të dhënash të cilat mblidhen dhe shqyrtohen gjatë procesit të vetingut të subjekteve të vetingut. Këtu përfshihen:</p> <p>i) të dhënat rreth pasurisë: ku objekti i verifikimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për të vetuarin;</p> <p>ii) të dhënat rreth profesionalizmit: ka të bëjë me vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Të dhënat lidhur me performancën të cilat duhen të vlerësohen, do të jenë të kufizuara. Vlerësimi nuk duhet të lëshohet në çështjet meritore të vendimeve. Mendohet se në këtë drejtim nuk duhet zgjeruar përtej asaj që është paraparë në Rregulloret aktuale për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve, të cilat në përgjithësi janë hartuar në maksimumin e lejueshmërisë së vlerësimit cilësor të vendimeve të pranuar nga</p>
------	-----------	---	---------------------	--

		<p>gjqtarit dhe prokurorit të transmetuara në dokumentet e tij / saj zyrtare, dhe, dy, aftësitë e gjyqtarit dhe prokurorit në argumentimin e tij / saj, në një mënyrë të plotë dhe të duhur. Kjo bazë do të vlerësojë nëse aftësitë e kandidatit e bëjnë atë të përputhshëm me nivelin e pritur të njohurive dhe aftësive të një gjyqtari ose prokurori, kryesisht duke marrë parasysh aspektet kryesore të profesionit, siç janë njohuritë mbi parimet kryesore të ligjit, degët specifike të ligjit ku bazohet juridiksioni i Zyrës, arsyetimi dhe aftësitë ligjore të shkrimit në lidhje me çështjen dhe pretendimet e palëve, etj.</p> <p>iii. c) Afërsia me qarqet kriminale dhe / ose partizane të atyre që i nënshtrohen vetingut; Një nga aspektet kryesore të përputhshmërisë së një figure të gjyqtarit ose prokurorit me kriteret për të drejtuar Zyrën është afërsia e tij / saj, jo domosdoshmërisht biznes ose ndërmarrje e përbashkët, me qarqet që konsiderohen të rrezikshme për një shërbim të pavarur për interesin publik dhe vendosjen e drejtësisë. Ato qarqe mund të shkojnë nga grupe kriminale në bashkësi</p>	<p>gjqtari/prokurori dhe aftësitë tjera profesionale. Gjithashtu, njëra nga kufizimet e bëra qartë nga Rekomandimet e Kievit (të shtjelluara më sipër), është se numri i vendimeve të kthyer nga gjykata e nivelit më të lartë nuk mund të shërbejë si kriter për matjen e performancës.</p> <p>iii) informata të tjera të lidhura për personalitetin: përfshirë informatat mbi lidhjet apo afërsitë politike të kandidatit, informatat e mbledhura nga terreni, informatat mbi shëndetin e subjektit të vetingut, përkatësisht informatat mbi varësitë apo gjendje shëndetësore që mund të ndikojnë në aftësinë për të gjykuar, apo devijime të tjera të lidhura me personalitetin të diagnostifikuara profesionalisht që ndikojnë në integritetin e kandidatit. Pra, të dhënat shëndetësore do të mbledhen për t'i shërbyer shqyrtimit të përgjithshëm të sjelljes së gjyqtarit dhe prokurorit. Mbledhja, përdorimi dhe ruajtja e informatave mbi shëndetin e kandidatit dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së këtyre informatave do të</p>
--	--	---	--

		<p>partizane të cilët në parim synojnë të ndërhyjnë në administrimin e drejtë të drejtësisë, edhe pse jo drejtpërdrejt. Ligji do të duhet të përcaktojë "afërsinë" në këtë drejtim me parametra më të qartë, siç kërkohet gjithashtu nga Komisioni i Venecias në rastin e Shqipërisë, dhe të deshifrojë kur situatat që dalin nga "afërsia me këto grupe" shkojnë në një rrethanë të papajtueshme. Ligji gjithashtu do të duhet të përcaktojë se cili lloj informacioni mund të përdoret për të bërë këtë vlerësim, duke përfshirë zakonisht informacionin e inteligjencës që duhet të kontrollohet dy herë nga komisioni i verifikimit për t'u siguruar që nuk komprometon të vërtetën. Afërsia me këto grupe do të rezultojë që gjyqtari ose prokurori të jenë automatikisht të pa denjë për të drejtuar Zyrën, duke marrë parasysh që kjo paraqet një situatë objektive që - edhe nëse nuk synohet të ndërhyjë në administrimin e drejtësisë - kjo ndikon negativisht në besueshmërinë dhe integritetin e gjyqtarit në sytë e opinionit publik që e bën atë plotësisht të</p>	<p>përcaktohen me ligj, duke u siguruar proporcionalitetin në raport me të drejtën në jetë familjare dhe të drejtën në privatësi.</p> <p>Për mbledhjen e këtyre të dhënave, fillimisht subjektet e vetingut do të dorëzojnë në panelet përkatëse nga një formular të plotësuar për secilën kategori të të dhënave, sipas specifikave të përcaktuara me ligj. Më pastaj, në lidhje me çështjet e specifikuar në formular, panelet do të verifikojnë saktësinë së këtyre të dhënave duke u bazuar në të dhënat mbledhura nga njësitë.</p> <p>Me ligj duhet të specifikohet qartë se cilat të dhëna mund të mbledhen, procedura e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të tyre e cila duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale; duhet të sanksionohet obligimi për proporcionalitetin në mes kufizimit të të drejtës në privatësi dhe jetë familjare e cila mund të rezultojë si shkak i kërkimit dhe verifikimit të të dhënave personale dhe informatave tjera me qëllimin legjitim i cili synohet</p>
--	--	--	--

papajtueshëm me kushtet e Zyrarit. Me anë të kësaj baze do të verifikoheshin edhe pabarazitë në pasuri dhe në të ardhura ndër vite.

që të arrihet përmes mbledhjes së këtyre të dhënave; duhet të përcaktohet kohëzgjatja e procedurës për mbledhjen e të dhënave dhe rrethanat se kur duhet të ndërprehet; të parashihet e drejta e palës (subjektit në procedurë) për ankimim, qoftë në aspektin material apo procedural të mbledhjes së këtyre të dhënave si dhe të parashihet asgjësmi i të dhënave personale sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast, mbledhja e të këtyre të dhënave dhe informatave dhe ndërhyrjet pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën gjyqësore të zhvilluar në çështje si vetingu ose lustrimi.

GLPS	Opsioni 4	<p>Tek pjesa që trajton masat që parashihen për gjyqtarë dhe prokurorë që nuk kalojnë procesin e vetingut në koncept dokument, GLPS rekomandon që procesi i vetingut duhet të shërbej si filtër për pastrimin e sistemit. Thënë këtë të gjithë ata të cilët nuk e kalojnë këtë proces duhet të largohen nga sistemi prandaj edhe propozimi për masa të tjera përveç që është i pakuptimit nuk ka asnjë vlerë. Rikujtojmë se me anë të procesit të vetingut si element mbizotërues do të jetë vlerësimi i integritetit të subjekteve që i nënshtrohen vetingut sidomos lidhjet e tyre me qarqet kriminale dhe partizane dhe ndikimi i tyre në ushtrimin e funksionit publik të dhënë sipas ligjit.</p>	Refuzohet	<p>Sipas standardeve ndërkombëtare, çfarëdo sanksioni në raport me zhvillimin në karrierë të gjyqtarit apo prokurorit, duhet të jetë proporcional me natyrën e shkeljes. Prandaj, Opsioni 4 parashihe sistem të përshkallëzuar të sanksioneve. Në rastet kur shkeljet apo mangësitë e caktuara të subjektit në cilëndo prej tre segmenteve të vlerësimit mund të sanohen, atëherë Mekanizmi mund të propozojë masa tjera.</p>
GLPS	Opsioni 4	<p>GLPS rekomandon që në rast se vlerësimi i mekanizmit është negativ dhe si pasojë vijmë deri tek shkarkimi i subjektit, të njëjtit të i ndalohet aplikimi në pozitën e gjyqtarit, prokurorit, kryeprokurorit dhe anëtarit të Këshillave për së paku 15 vite. Pra, GLPS propozon që kjo ndalesë të shprehet me vite.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Në rast se vlerësimi i mekanizmit është negativ dhe i njëjti propozon shkarkimin e subjektit, të njëjtit do t'i ndalohet aplikimi në pozitën e gjyqtarit, prokurorit, kryeprokurorit dhe anëtarit të Këshillave.</p>

IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Problemet e pasqyruara në Draft-Koncept Dokument, nuk ndërtojnë legjitimitet për zhvillimin e një procesi të vetingut, pa marrë parasysh se cili model do të jetë ai. Kjo pasi në bazë të Draft-Koncept Dokumentit, sistemi i drejtësisë, përkatësisht akterët e sistemit të drejtësisë, pothuajse nuk kanë fare problem me integritetin, fakt i cili nuk qëndron në praktikë. Siç do të argumentohet në vijim, problematika e integritetit në sistemin e drejtësisë nuk paraqitet si diçka reale, problematike dhe e matshme, por se më tepër paraqitet si një dukuri abstrakte.</p> <p>Në këtë kuptim, ndikimi politik më shumë citohet nga raportet ndërkombëtare si citat, se sa që paraqitet në gjendjen e tij reale brenda sistemit të drejtësisë. Kështu, ndikimi politik kategorizohet si një nocion abstrakt duke mos ju dhënë rëndësia e merituar në kuptim të problemit që ky ndikim paraqet brenda sistemit të drejtësisë.</p> <p>Aspekt tjetër shumë negativ i cili nuk trajtohet dhe elaborohet mjaftueshëm në Draft-Koncept Dokument është ndikimi i sistemit të</p>	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 3.
-----	-----------------------	--	---------------------	------------------------------

		<p>drejtësisë nga ana e grupeve të interesit. Kjo do të duhej të konkretizohej edhe me raste praktike të raportuara në publik. Mos paraqitja e këtij problemi në sistemin e drejtësisë, paraqet pasqyrën se sistemi i drejtësisë është i kursyer nga ky problem, i cili krucialisht ndikon në ndërtimin e legjitimitetit për zhvillimin e procesit të vetingut.</p>		
--	--	---	--	--

IKD	Koment i përgjithshëm	Sa i përket besueshmërisë së qytetarëve në sistemin e drejtësisë, në këtë pjesë duhet paraqitur edhe raporte kredibile të cilat kanë matur nivelin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që besueshmëria e sistemit të drejtësisë përballë qytetarëve, të paraqitet në shifra sa më të matshme .	Pranohet pjesërisht	<p>Në raportet ndërkombëtare, Kosova vazhdon të rangohet si njëra nga vendet me korrupsion të lartë. Transparency International e rangon Kosovën në vendin e 104, me vetëm 32 pikë nga 100 sosh. Për më tepër, qysh nga viti 2012, Kosova ka pasur ngritje për vetëm dy pozita në këtë rangim. Për të luftuar një shkallë të këtyllë të korrupsionit, funksionimi i mirëfilltë, i paanshëm dhe i pacënuar i gjyqësorit dhe prokurorisë është jetik. Megjithkëtë, raporti i Komisionit Evropian për disa vite me rradhë, përfshirë edhe në vitin 2020, ka konkuduar se “gjyqësori është ende i cenueshëm nga ndikimi i papërshtatshëm politik” dhe se “administrimi i drejtësisë mbetet i ngadaltë dhe joefikas dhe institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë për përpjekje të vazhdueshme për të ngritur kapacitetet e tyre”.</p> <p>Konstatime të ngjashme janë bërë edhe nga Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, të cilat identifikojnë mosndëshkimin e zyrtarëve të korruptuar si njërin nga problemet më të mëdha në vendin tonë. Sipas tyre, “mungesa e mbikqyrjes</p>
-----	-----------------------	--	---------------------	--

			<p>efektive të gjyqësorit si dhe dobësia e përgjithshme e sundimit të ligjit ka kontribuar në këtë problem”. Më me rëndësi, ky raport thekson se “rastet e korrupsionit vazhdimisht kanë qenë subjekt i apelimit, dhe sistemi gjyqësor shpesh i ka lejuar afatet e parashkrimit që të rrjedhin pa i gjykuar rastet”.</p> <p>Në raportin e vitit 2019, i njëjti burim thekson se përkundër garancive kushtetuese për të siguruar pavarësinë, sistemi gjyqësor shpesh nuk ka arritur gjykim të drejtë, duke qenë i ngadalshëm dhe duke mos e garantuar llogaridhënien e zyrtarëve. Sërisht, ky burim konkludon se “strukturat gjyqësore ishin subjekt i ndërhyrjeve politike, me emërime të kundërshtuara dhe mandate të paqarta”.</p> <p>Raporti i brendshëm i misionit kolegjial të Komisionit Evropian thekson se prokurorët kanë presion dhe ndërhyrje nga jashtë, përfshirë këtu mediat, policia, të dyshuarit por edhe nga vetë eprorët e tyre. Ata gjithashtu cekin përshtypjen se ka ndikim politik mbi zyrën e prokurororit të shtetit e cila, sipas tyre, reflektohet në</p>
--	--	--	--

			<p>numrin e ulët të rezultateve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Probleme me ndërhyrje politike janë raportuar edhe nga gjyqtarët. Anketa e opinionit publik nga ana e NDI-së Amerikane konkludon se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është mjaft i ulët, ku veçanërisht gjyqësori dhe prokuroria shihen nga publiku si institucione të ndikuara nga korrupsioni dhe politika. Si indikacione të ndikimit të politikës në gjyqësor, shoqëria civile ka cilësuar rezultatet e munguara në luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë; si dhe dënimet e lehta të shqiptuara edhe në rastet e pakta të trajtuara.</p> <p>Ngjashëm me këtë, raporti i UNDP-së mbi pulsin publik për vitin 2020, tregon një shkallë shumë të ulët të kënaqshmërisë së popullatës me gjyqësorin. Në të njëjtën frymë, raportet e punuara nga organizata të ndryshme vendore të shoqërisë civile kanë shpërfaqur një numër të konsiderueshëm të parregullsive në gjyqësor (TBC)</p>
--	--	--	---

IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 47 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Megjithatë, siç u evidentua në hyrje të këtij Koncept Dokumenti, vazhdimisht është vlerësuar dhe raportuar se sistemi i drejtësisë në Kosovë është i ndikuar dhe i ndikueshëm nga grupet e ndryshme të interesit, politika dhe faktorë të tjerë të jashtëm. Për më shumë ka edhe mungesë të profesionalizmit në sistem. Si rrjedhojë, gjyqtarët dhe prokurorët, por edhe nëpunësit civil në pozita të larta mund të ndërmarrin veprime ose nxjerrin vendime të cilat nuk i shërbejnë drejtësisë dhe qëllimit kushtetues dhe ligjor, për të cilin duhet të shërbejnë”.</p> <p>Për një vëzhgues objektiv, ky përcaktim në këtë pjesë të Draft-Koncept Dokumentit është një gjuhë “amnistuese”. Për vëzhguesit e tillë, duhet të bëhet e qartë se ky ndikim konsiston qartazi në shndërrimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë në institucione që i shërbejnë politikës dhe grupeve të interesit. Si rrjedhojë, kjo ndikon që sistemi i drejtësisë të mos jetë në gjendje që të luftojë edhe kriminalitetin e</p>	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 23.
-----	-----------------------	---	---------------------	-------------------------------

		<p>akterëve të caktuar politik apo grupeve të interesit. Si efekte të kësaj, paraqitet fakti se këta akterë politikë dhe grupe të interesit, shndërrohen në grupe të fuqishme në shoqëri, të paprekura nga drejtësia. Ky fakt dhe këto efekte, IKD rekomandon që të përfshihen në këtë pjesë të Draft-Koncept Dokumentit.</p>		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 52 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Si rrjedhojë e këtyre shifrave, janë paraqitur vështirësi edhe me rastin e avancimit të gjyqtarëve, respektivisht, prokurorëve, ku për shkak të vlerësimit kryesisht identik të performancës për ta, nuk është arritur të ndihmohet në përzgjedhjen e kandidatit më profesional”. Në këtë pjesë, IKD rekomandon që në kontekst të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtohet edhe fjalia si në vijim. “...Për shkak të kësaj, edhe manipulimet eventuale me rastin e</p>	Pranohet plotësisht	

		<p>avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është vështirë të provohen, për arsye se pothuajse të gjithë kandidatët kanë nivel të njëjtë të aftësive formale dhe ky fakt rrit edhe potencialin për arbitraritet me rastin e avancimeve të gjyqtarëve apo prokurorëve”.</p>		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 53 të Draft-Koncept Dokumentit flitet për mosfunksionim korrekt të mekanizmave të disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Edhe në këtë pjesë, arsyetimi është në nivel abstrakt dhe dështimin e këtyre mekanizmave nuk ia atribuon fajtorit kryesor: Mungesës së vullnetit dhe integritetit të akterëve të sistemit të drejtësisë për zbatimin efikas dhe efektiv të mekanizmave të disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Llogaridhënia në Kosovë ka dështuar fillimisht me sistemin e disiplinimit përmes Zyrës së Prokurorit Disiplinor, i cili dështim është pothuajse fakt notor. Sa i përket sistemit të ri të llogaridhënies përmes Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, IKD në një</p>	Pranohet plotësisht	<p>Pavarësisht faktit se me legjislacionin në fuqi, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial kanë mundësi që të përshtatin zbatimin e detyrave të tyre, përmes miratimit të akteve nënligjore, vullneti për një gjë të tillë në rastin e njërive për verifikim ka munguar.</p>

		<p>raport përmes akterëve me emra konkret ka paraqitur faktorët që kanë ndikuar në dështimin e sistemit të ri të llogaridhënies përmes Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve .</p>		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Tutje, në faqen 49 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “KGJK ka nxjerrë edhe Rregullore specifike për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së në vitin 2017. Aty si kriter, ndër të tjera, theksohet reputacioni i lartë profesional dhe integriteti personal që kandidatë për këtë pozitë duhet të kenë, por për këtë çështje nuk ka pasur procedurë formale të verifikimit”. KGJK kishte miratuar këtë rregullore më 16 maj 2017, në nenin 10 të të cilës rregullore, KGJK i kishte përcaktuar vetës obligimin për miratimin e një rregullore të re për vlerësimin, disiplinimin dhe shkarkimin e drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Konsiderohet se çështja e bazës ligjore dhe rregullativës së zbatueshme në këtë rast ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së ka mbetur pezull dhe në amulli sipas Aktgjykimi nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese.</p>

		<p>Përkundër kësaj, IKD gjatë monitorimit ka gjetur se KGJK asnjëherë nuk e ka miratuar këtë rregullore. Si rrjedhojë, pa ndonjë arsye objektive, KGJK nuk ka përcaktuar mekanizmin e disiplinimit të drejtorit të sekretariatit të KGJK-së, ashtu siç e kishte obliguar veten përmes kësaj rregulloreje.</p>		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 52 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Më mirë nuk qëndron as llogaridhënia në raport me publikun ku ndër vite është raportuar për vështirësi në qasje të informatave si dhe për raporte vjetore me të dhëna jo gjithëpërfshirëse dhe të fragmentarizuara”. Me këtë rast, për të qenë sa më objektiv, edhe Draft-Koncept Dokumenti duhet ta njohë progresin në këtë fushë nga të dy (2) sistemet, veçanërisht nga ai gjyqësor.</p>	Pranohet plotësisht	

IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në të njëjtën faqe (52) të Draft-Koncept Dokumentit nënvizohet se “Tani për tani, të dyja Këshillat kanë miratuar rregullore të reja të matjes së performancës për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilat fokusohen më shumë në kritere cilësore”. Me këtë rast, IKD rekomandon që në Draft-Koncept Dokument duhet të theksohet fakti se këto rregullore janë ndryshuar vazhdimisht. Përpos që këto ndryshime nuk kanë siguruar cilësi, ky ndryshim i shpeshtë deri në një masë ka cenuar edhe sigurinë juridike të subjekteve të cilat i nënshtrohet vlerësimit të performancës.</p>	Pranohet plotësisht	
-----	-----------------------	--	---------------------	--

IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 54 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “2.Përtej humbjes së besimit në drejtësi, si pasojë paraqitet edhe shkelja e të drejtave të njeriut. Janë raportuar ndër vite raste të shumta të parashkrimit të lëndëve dhe shkeljet e afateve ligjore të qëllimshme nga ana e profesionalistëve brenda sistemit. Dukuri si këto me të cilat përballet qytetari i cenojnë atij, ndër të tjerash, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë dhe me të drejtën ndërkombëtare 3.Dhe së fundi, mungesa e integritetit në sistemin e drejtësisë afekton negativisht edhe zhvillim ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Kjo qoftë me mungesën e investimeve nga jashtë, të cilat kërkojnë si parakusht një sistem të drejtësisë së qëndrueshme dhe të drejtë, ashtu edhe stagnimi në rrugëtimin e Kosovës drejtë integrimeve euroatlantike”. Si qëndrim, IKD pajtohet dhe e sheh shumë me vend një nënvizim të tillë. Por se, me qëllim që i njëjti të jetë sa më i matshëm dhe i besueshëm për një vëzhgues objektiv, arsyetimi i këtyre dy (2) efekteve nuk duhet të merret</p>	Pranohet pjesërisht	Është mbuluar mjaftushëm në koncept dokument.
-----	-----------------------	---	---------------------	---

		<p>si i mirëqenë, por duhet edhe të detajohet me gjetje të raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, në të cilat është dhënë arsyetim meritor lidhur me këto efekte</p>		
--	--	--	--	--

IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Problematikë tjetër relevante për të cilën IKD rekomandon që të përfshihet në Draft-Koncept Dokument janë edhe disa nga elementet që ndërtojnë argumentin e lidhjes së gjyqtarëve të caktuar me politikën . Në këtë kuptim, në faqen 96 të Draft-Koncept Dokumentit, kur përshkruhet përvoja e Shqipërisë me procesin e vetingut, ndër të tjera, thuhet se “Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të vlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar ndër tjera janë :</p> <p>a) është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jo rastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;... e) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar”.</p> <p>Fotografitë, takimet dhe raportimet përkitazi me takimet e akterëve të sistemit të drejtësisë me akterë politikë dhe persona</p>	Pranohet pjesërisht	Është mbuluar mjaftushëm në koncept dokument.
-----	-----------------------	---	---------------------	---

		<p>të tjerë të cilët kanë probleme me ligjin kanë qenë të vazhdueshme. Në kuptim të ndërtimit të arsyeshmërisë për ndërtimin e kritereve të kësaj natyre, pasqyrimi i kësaj problematikë në këtë pjesë të Draft-Koncept Dokumentit është një domosdoshmëri tjetër.</p>		
--	--	--	--	--

IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 27 dhe 28 të Draft-Koncept Dokumentit si ligj relevant listohet edhe Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.</p> <p>Përkitazi me këtë ligj, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në aktgjykimin KO203/19 ka theksuar se “Me këtë zgjidhje legislative është siguruar që Qeveria, respektivisht Ekzekutivi nuk do të ketë kompetenca “ndërhyrëse” në menaxhimin e nëpunësve të Kuvendit, respektivisht Legjislativit; ndërkaq që për pushtetin e Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura nuk është paraparë asnjë garanci për të parandaluar “ndërhyrjet” në menaxhimin e nëpunësve të tyre. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se Kuvendi ka dështuar që të njëjtin përjashtim ta përcaktojë edhe për nëpunësit e Gjyqësorit dhe të Sistemit të Drejtësisë, ashtu që të siguronte ndarjen e pushteteve jo vetëm në aspekt të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe lidhur me stafin mbështetës të tyre, njësoj sikurse kishte bërë për nëpunësit e Kuvendit dhe të Qeverisë”. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së</p>	Pranohet pjesërisht	Meqenëse sipas Aktgjykimit KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese, çështja e rregullimit ligjor të administratës së gjyqësorit ka mbetur pezull dhe në amulli, referenca në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është mbajtur, në mungesë të një ligji të ri.
-----	-----------------------	--	---------------------	--

		<p>Kosovës ka vendosur se “TE KONSTATOJE qe Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publike nuk zbatohet ne raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur te Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë” .</p> <p>Si rrjedhojë, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nuk vlenë për institucionet e sistemit të drejtësisë. Për këtë arsye, IKD rekomandon që ky ligj të fshihet nga kjo pjesë e Draft-Koncept Dokumentit.</p>		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 43 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Duke qenë se vetingu në Polici të Kosovës, Inspektorat Policor të Kosovës, AKI dhe institucione tjera bie jashtë kompetencës së Ministrisë së Drejtësisë, zhvillimi i procesit në këto institucione do të ndërmerret në koordinim me Ministrinë e Punëve të</p>	Pranohet plotësisht	

		Brendshme, gjegjësisht Zyrën e Kryeministrit”.		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në faqen 58 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Vlerësimet e performancës dallojnë nga vetingu apo kontrolli i integritetit. Vetingu dhe verifikimet e së kaluarës synojnë adresimin e integritetit dhe cenueshmërive, ndërsa vlerësimet adresojnë kompetencën dhe potencialin. Implikimet e proceseve janë të ndryshme: dështimi i një procesi të verifikimit mund të rezultojë që një kandidat jo kompetent mos të emërohet në një pozitë, mos t’i jepet qasje në materialin e ndjeshëm ose mos të largohet nga pozita që e mban; ndërsa pasoja e performancës së dobët në një vlerësim është zhvillim profesional”.</p> <p>Fillimisht, IKD pajtohet me faktin se vlerësimi i performancës dallon nga vetingu apo kontrolli i integritetit si dhe mirëpret faktin se ky dallim bëhet në këtë koncept dokument. Por, në këtë rast, me qëllim të saktësisë objektive, duhet të</p>	Pranohet pjesërisht	Është mbuluar mjaftushëm në koncept dokument.

		<p>pasqyrohen drejt pasojat e vlerësimit të dobët të performancës, për të cilin vlerësim, gjyqtarët dhe prokurorët mund edhe të shkarkohen. Në praktikë, kjo nuk ka ndodhur asnjëherë .</p>		
IKD	Koment i përgjithshëm	<p>Në kapitullin 1.4. të Draft-Koncept Dokumentit, ndër të tjera, trajtohet edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë rast, IKD rekomandon që këtij elaborimi ti shtohet edhe elaborimi në kuptim të fuqisë juridike që kjo Konventë ka në sistemin juridik Kosovar, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Po ashtu, në kapitullin 1.4.1. të Draft- Koncept Dokumentit janë listuar Instrumentet multilaterale dhe rajonale me karakter detyrues. Në këtë listë, IKD rekomandon që të futet edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, obligimi për zbatimin e së cilës rrjedh nga neni 53 i Kushtetutës së</p>	Pranohet plotësisht	

		<p>Republikës së Kosovës. Për më tepër, me këtë rast, do të theksohej edhe obligimi kushtetues për zbatimin e të gjitha standardeve relevante në procesin e vetingut, të cilat standarde janë ndërtuar në raste të ndryshme nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.</p>		
IKD	Opsioni 1	<p>Ka shumë arsye të tjera të cilat mund të trajtohen në këtë pjesë, të cilat do të argumentohet rreziku nëse me apo pa vendimmarrje, shkohet me opsionin e parë. Këto arsye, duhet të jenë ekuivalente me problemet e identifikuar në pjesët paraprake në këtë Draft-Koncept Dokument. Po ashtu, problemet këtu vetëm se janë të identifikuar në RFSSL. Por se, në kuptim të qëllimit të procesit të vetingut, argumentimi duhet të ndërtohet përmes gjetjeve që kanë për objekt integritetin, dhe jo efikasitetin, siç ka ndodhur në këtë pjesë. Në këtë kuptim, IKD rekomandon që kjo pjesë të rishikohet dhe plotësohet.</p>	Pranohet pjesërisht	Është mbuluar mjaftushëm në koncept dokument.

IKD	Opsioni 2	<p>Krahas mekanizmit të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, mekanizëm tjetër ekzistencial i sistemit gjyqësor dhe prokurorial është mekanizmi i llogaridhënies. Ky mekanizëm nuk ka dështuar për shkak të problemeve ligjore, por për shkak të mungesës së vullnetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të mbajtur llogaridhënës gjyqtarët dhe prokurorët. Për këto arsye, IKD rekomandon që krahas elaborimit të mungesës së bazës së mjaftueshme ligjore për verifikimin e vazhdueshëm të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pamundësia e zgjidhjes së problemit përmes këtij opsioni të arsyetohet edhe përmes mungesës së vullnetit të KGJK-së dhe KPK-së për të mbajtur llogaridhënës gjyqtarët dhe prokurorët, duke mbrojtur kështu integritetin e sistemit të drejtësisë dhe besimin e qytetarëve në këtë sistem.</p>	Pranohet plotësisht	
-----	-----------	---	---------------------	--

IKD	Opsioni 3	<p>Sa i përket sistemit të decentralizuar, një sistem i tillë ka qenë edhe në të kaluarën, ku llogaridhënia e gjyqtarëve dhe prokurorëve është adresuar përmes Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Dështimi i këtij sistemi të llogaridhënies tanimë është pothuajse fakt notor. Në esencë, nëse vendimmarrja përfundimtare i ipet këshillave, atëherë vetëm kemi të bëjmë me ndërtimin e një sistemi, i cili sistem ka qenë paraprakisht dhe është dëshmuar si i dështuar, për të cilën arsye tanimë edhe është shuar.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Duhet të theksohet se analiza e zhvilluar në Opsionin 3, parasheh zhvillimin e vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë në përputhje me kornizat dhe rrjedhimisht kufizimet që i përcakton Kushtetuta. Si rrjedhojë, është e pamundur që çfarëdo ndërhyrje vetëm përmes ndryshimit të legjislacionit, të anashkalojë kompetencat kushtetuese të Këshillave. Sistemi është modeluar në frymën e ndarjes së pushteteve që përcakton Kushtetuta. Vendimmarrja përfundimtare ju është lënë këtyre organeve, pikërisht për shkak të përcaktimeve kushtetuese.</p>
IKD	Opsioni 3	<p>Thënë më ndryshe, “vetingu” ku vendimmarrjen përfundimtare e kanë këshillat, nuk paraqet fare veting. Andaj, IKD rekomandon që në Draft-Koncept Dokument, kjo mangësi të elaborohet mjaftueshëm dhe të paraqitur si e metë çfarë realisht është, dhe jo vetëm të citohet.</p>	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 38.

IKD	Opsioni 3	<p>Një çështje tjetër, të cilës Draft-Koncept Dokumenti nuk i jep përgjigje është mekanizmi për vetimin e vet anëtarëve të këshillit. Përkundër faktik që Draft-Koncept Dokumenti paraqet disa aspekte në drejtim të vetimit të anëtarëve të këshillave, nuk e përcakton institucionin i cili do të bëjë këtë vetim. Në kontekst të asaj që elaborohet në Draft-Koncept Dokument dhe nga limitet kushtetuese përkitazi me këtë fushë, del se mënyra e vetme e vetimit të këtyre anëtarëve të këshillave është vetimi nga vet këshillat. Logjika e kësaj konsiston, të paktën, në vetimin e anëtarëve të këshillave nga kolegët e tyre, të cilët kolegu më pas do të vetohen pikërisht nga anëtari tanimë i vetuar nga po të njëjtit. Një situatë të tillë, e paraqet vetëm mbivlerësimi i këtij opsioni dhe heshtja e Draft-Koncept Dokumentit përballë integritetit të kontestuar të këshillave për të ngritur llogaridhënien, integritetin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Duhet rikujtuar se bazuar në përcaktimet kushtetuese, anëtarët e këtyre mekanizmave do të zgjedhen nga Këshillat përkatës (KGJK/KPK). Në këtë drejtim, për të siguruar cilësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e mekanizmave, parashihet që procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të tyre të jetë transparent dhe rigoroz. Është e rëndësishme që me rastin e rekrutimit, të ketë një përfshirje të akterëve jashtë strukturave aktuale gjyqësore dhe prokuroriale. Kjo pasi, në fazën kur duhet përzgjedhur anëtarët e secilit prej mekanizmave, përfshirë stafin në Sekretariat dhe panele, anëtarët e Këshillave nuk do të jenë të vetuar.</p> <p>Procedura përmes së cilës parashihet të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të mekanizmave, ndonëse do të niset me konkurs dhe përfundohet nga vetë Këshillat, do të ketë përfshirje të madhe të mekanizmave gjegjëse ndërkombëtar. Këshillat do të mund të kontraktjnë apo të bëjnë marrëveshje mirëkuptimi me trupa apo organizata ndërkombëtare për të kërkuar ndihmën e</p>
-----	-----------	---	---------------------	---

			<p>tyre në përzgjedhjen, përfshirë vlerifikimin, e anëtarëve të mekanizmave respektiv. Një model i ngjashëm me këtë mund të shihet aktualisht në Kosovë në modalitetet e gjetura për përzgjedhjen e Pozitave të Larta Drejtuese, procedura këto në të cilat intervistimi dhe rekomandimi vie nga trupa me përbërje ndërkombëtare (shembull me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë).</p> <p>Pas përfundimit të procesit verifikues, do të dilet me rekomandimin për emrat të cilët propozohet që të zgjedhen nga Këshillat për të qenë anëtarë të mekanizmave. Emrat e personave të rekomanduar për t'u zgjedhur duhet të jenë publik, bashkë me arsyetimet për rekomandimin e tyre.</p> <p>Megjithatë, ritheksohet se vendimi final për zgjedhjen e tyre si anëtarë të mekanizmave, merret nga vetë Këshilli përkatës. KGJK/KPK mund të refuzojnë emërimin apo përzgjedhjen e një apo më shumë të rekomanduarve, por duhet të arsyetojnë vendimin e vet për këtë, pavarësisht asaj se</p>
--	--	--	--

			<p>a do të përcaktohet që votimi të jetë i fshehtë apo publik. Në rast të refuzimit të ndonjë anëtari, rekomandohet një kandidat tjetër i verifikuar.</p> <p>Duke u shërbyer me përvojën e vendeve tjera të trajtuara më sipër dhe në frymë e standardeve ndërkombëtare, si element tjetër për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e punës së mekanizmave është kohëzgjatja e mandatit të tyre. Anëtarët e mekanizmit të vetingut do të kenë mandat që do të zgjatë po aq sa procesi i vetingut.</p> <p>Është thelbësore ndërmarrja e procesit të verifikimit për kandidatët për anëtarë të mekanizmave, kjo pasi që ata që bëjnë vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet vetë të jenë subjekte të verifikuar në mënyrë. Kështu, ofrohet garanci që procesi nuk do të jetë i cënueshëm në dëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen vetingut.</p> <p>Nga ana tjetër, procedura e hapur dhe e monitoruar ndërkombëtarisht, si dhe verifikimi nga jashtë sistemit i dy mekanizmave, janë faktorët kryesorë për të</p>
--	--	--	--

				<p>ruajtur procesin nga brenga potenciale për konflikt të interesit, i cili mund të vie për shkak të rolit të KGjK-së, gjegjësisht KPK-së në emërimin përfundimtar të anëtarëve.</p>
--	--	--	--	--

IKD	Opsioni 3	<p>Në faqen 179 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Sipas KGJK-së, e rëndësishme është që nuk do të duhej të kishte asnjë trajtim ndryshe të gjyqtarëve në raport me zyrtarët e tjerë të lartë përkitazi me procesin e verifikimit të pasurisë së tyre, sepse kjo bie ndesh me vet dispozitat e kontrollit të pasurisë bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin e Pasurisë”. IKD vlerëson se ky qëndrim i KGJK-së nuk është i arsyeshëm. Rëndësia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe integriteti i kontestuar i këtyre dy (2) sistemeve, pa mëdyshje e ndërtojnë legjitimitetin për trajtim më specifikim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për më tepër, IKD vlerëson se KGK në këtë rast nuk mund të thirret në Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, pasi ky ligj shërben vetëm në fushën e deklarimit të pasurisë të të gjithë zyrtarëve të lartë dhe nuk mund të konsiderohet si “kushtetutë” për të gjitha problemet që evidentohen në institucionet publike, në rastin konkret në institucionet e sistemit të drejtësisë.</p>	Pranohet plotësisht	
-----	-----------	--	---------------------	--

IKD	Opsioni 3	<p>Në faqen 169 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Segmenti i sigurimit dhe analizimit të të dhënave mbi pasurinë e të vetuarve, do t’i lihet AKK-së, ku mendohet të krijohet një njësi e veçantë për veting. Kjo njësi ka kompetencë të zgjeruar dhe ka resurset e duhura për të hetuar detajisht pasurinë e kandidatit. Të gjeturat, në formë të vlerësimit të pasurisë, njësia i përcjellë pastaj në KGJK dhe KPK. Ngjashëm me komisionin për vlerësimin e avancuar të performancës, për t’u punësuar në këtë njësi, kandidatët duhen të kalojnë procedura rigoroze të vetingut, me prezencë ndërkombëtare. Në kuadër të këtij modeli të decentralizuar, kjo njësi do të funksiononte përherë në kuadër të AKK-së. Për këtë arsye, është e nevojshme që të preken edhe kompetencat e AKK-së për të sqaruar këtë”. Përkitazi me involvimin e AKK-së në këtë proces, pa marrë parasysh se çfarë kompetencash i listohen AKK-së, kjo agjenci e ka të pamundur të zhvillojë hetim tjetër pos hetimit administrativ. Dhënia e kompetencave të tjera të agjencisë në këtë fushë,</p>	Pranohet plotësisht	
-----	-----------	---	---------------------	--

		<p>paraqet shkelje të kushtetutës. Niveli i hetimit administrativ në asnjë rrethanë nuk mund të gjenerojë informata të cilat nevojiten për verifikimin e një gjyqtari apo prokurori. Kjo ka qenë e dëshmuar edhe në praktikë, ku për shkak të këtij niveli të mundësisë së AKK-së për hetim, sistemi i deklarimit të pasurisë nuk i ka dhënë efektet që synon. Në anën tjetër, është e pakuptueshme se si mëtohet që pikërisht kësaj agjencie ti ipet një rol kaq i rëndësishëm në kuadër të procesit të vetingut, kur Ministria e Drejtësisë të njëjtës agjenci nuk ia ka besuar edhe menaxhimin me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, por se ka vendosur që ta themelojë një agjenci të re. Për këto arsye, IKD rekomandon që përfshirja e AKK-së në këtë rast, të largohet nga Draft-Koncept Dokumenti.</p>		
--	--	---	--	--

IKD	Opsioni 3	<p>Sa i përket të dhënave lidhur me personalitetin, në faqen 169 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Varianti i parë është që kjo të bëhej nga AKI e cila bazuar në të gjeturat përpilon vlerësim gjysmë konfidencial që i dorëzohet mekanizmit për veting në kuadër të KGJK/KPK. Është parë rezistencë nga anëtarët e grupit punues në lidhje me involvimin e këtij institucioni në këtë proces. Opinioni i Komisionit të Venecias (Amicus Curiae, 2016, para 53- 55), len të kuptohet se pjesëmarrja e organeve të këtilla të inteligjencës nuk është e kundërshtueshme parimisht, përderisa të gjeturat e tyre janë më pas janë subjekt i mbikëqyrjes dhe ankimimit nga anëtarët të tjerë të mekanizmit. Të dyja alternativat që diskutohen këtu, në kuadër të këtij Opsioni, parashohin që vlerësimet e këtyre njësive të jenë objekt i diskutimit dhe vendimmarrjes nga KGJK/KPK. Prandaj, kjo kërkesë do të përmbushej”. Para së gjithash, ky përcaktim i Draft-Koncept Dokumentit është i përealizueshëm sipas këtij opsioni, pasi është në kundërshtim me Kushtetutën</p>	Pranohet plotësisht	
-----	-----------	--	---------------------	--

		<p>e Republikës së Kosovës. Neni 129 i kësaj kushtetute përcakton se “Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës”. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, mandati i Agjencisë Kosovare për Inteligjencë është vetëm në drejtim të kërcënimeve ndaj sigurisë së Republikës së Kosovës dhe nuk mund të shtrihet edhe në fusha të tjera, si në rastin konkret. Kompetencë adekuate e AKI-së për rastin konkret nuk gjendet as në Ligjin NR. 03/L-063 për Agjencinë Kosovare për Inteligjencë. Për këtë arsye, në kuadër të këtij opsioni, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk lejon implikimin e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, për të cilën arsye, IKD rekomandon që pjesët ku përcaktohet implikimi i AKI-së në proces të vetingut, sipas këtij opsioni, të fshihen nga Draft-Koncept Dokumenti.</p>		
--	--	---	--	--

IKD	Opsioni 3	<p>Krahas AKI-së, si variant i dytë për mbledhjen e të dhënave lidhur me personalitetin e subjektit të vetingut është edhe krijimi i një (1) njësie të veçantë. Përkitazi me këtë, në faqen 169 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Varianti i dytë është rekrutimi në kuadër të njësisë së veçantë në KGJK/KPK i një stafi të trajnuar në inteligjencë për të siguruar të dhënat të lidhura për personalitetin e kandidatit dhe në bazë të tyre përpilon raportin gjysmë konfidencial”. Sikurse u tha në rastin e AKK-së, në kuadër të limiteve që përcakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, asnjë institucion nuk mund të mbledhë të dhëna përtej të dhënave që mund të sigurohen përmes hetimit administrativ. Niveli i të dhënave që sigurohen përmes këtij hetimi, nuk është i mjaftueshëm për vetimin efektiv të subjektit të vetingut, derisa dhënia e më shumë kompetencave kësaj njësie është kundër kushtetuese. Për këtë arsye, IKD rekomandon që pikërisht pamundësia e mbledhjes së të dhënave të mjaftueshme që kanë të bëjnë me integritetin e subjektit të</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Mbledhja, përdorimi dhe ruajtja e informatave mbi shëndetin e kandidatit dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së këtyre informatave do të përcaktohen me ligj, duke u siguruar proporcionaliteti në raport me të drejtën në jetë familjare dhe të drejtën në privatësi.</p>
-----	-----------	---	---------------------	---

		vetuar të përmendet si e metë e këtij opsioni.		
IKD	Opsioni 4	Në faqen 183 të Draft-Koncept dokumentit thuhet se “Me ndryshime kushtetuese duhet të përcaktohet që mekanizmi për veting të përbëhet nga dy organe: i) organi kompetent për zhvillimin e procesit të vetingut dhe ii) organi për ankimim”. Në kuptim të këtij opsioni, me qëllim të administrimit të procesit të vetingut por edhe ruajtjes së integritetit të procesit të vetingut, e rëndësishme është që e ndryshime kushtetuese të përcaktohet edhe një mekanizëm i tillë për administrimin dhe monitorimin e procesit të vetingut, i cili mekanizëm do të përbëhej nga ekspert	Pranohet pjesërisht	Procedura përmes së cilës parashihet të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të mekanizmave, ndonëse do të niset me konkurs dhe përfundohet nga vetë Këshillat, do të ketë përfshirje të madhe të mekanizmave gjegjëse ndërkombëtarë. Këshillat do të mund të kontraktojnë apo të bëjnë marrëveshje mirëkuptimi me trupa apo organizata ndërkombëtare për të kërkuar ndihmën e tyre në përzgjedhjen, përfshirë vlerifikimin, e anëtarëve të mekanizmave respektiv. Një model i ngjashëm me këtë mund të shihet aktualisht në Kosovë në modalitetet e gjetura për

		<p>ndërkombëtarë. Sipas vlerësimit të IKD-së, këta ekspertë do të zgjidhen përmes një konkursi ndërkombëtar, të menaxhuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, mbi bazën e përvojës dhe ekspertizës së dëshmuar në administrimin e drejtësisë, çështjet penale, civile, kushtetuese, të drejtat e njeriut etj. Komisionet brenda Kuvendit që do të menaxhojnë me këtë konkurs do të jenë gjithëpërfshirëse dhe me konsensus politik të partive të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, me dhe me obligime specifike për ruajtjen e integritetit të procesit në këtë fazë. Këto çështje, në detaje, do të trajtohen me rastin e draftimit të amendamenteve kushtetuese dhe Ligjit për Veting.</p>		<p>përzgjedhjen e Pozitave të Larta Drejtuese, procedura këto në të cilat intervistimi dhe rekomandimi vie nga trupa me përbërje ndërkombëtare (shembull me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë). Pjesëmarrje monitorues do të kërkohet nga partnerët ndërkombëtarë edhe përgjatë gjithë periudhës sa zgjatë vetingu.</p>
--	--	---	--	--

IKD	Opsioni 4	<p>Në faqen 184 të Draft-Koncept Dokumentit thuhet se “Anëtarët e mekanizmit do të vetohen fillimisht nga një organ me asistencë ndërkombëtare para rekrutimit dhe në mënyrë periodike. Anëtarët e paneleve do të zgjedhën nga Kuvendi dhe Presidenca”. Lidhur me këtë zgjidhje, IKD konsideron se nuk është më e duhura. Vetëm verifikimi paraprak i kandidatëve të cilët më pas zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duket të jenë një zgjidhje jo e mirë. Në këtë drejtim, si zgjidhje më efikase dhe më e drejtë do të ishte që mekanizmi për administrimin dhe monitorimin e procesit të vetingut do të përzgjedhë, vetojë dhe më pas propozojë anëtarët për panelet përkatëse. Mbi këtë propozim, do të vendosë Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili nuk mund të veprojë në mungesë të këtij propozimi. Në këtë mënyrë, edhe sigurohet kredibiliteti, profesionalizmi dhe vetimi i anëtarëve të paneleve vlerësuese por edhe ruhet e drejta e Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në këto panele.</p>	Refuzohet	Shih sqarimin në rreshtin 11.
-----	-----------	--	-----------	-------------------------------

IKD	Opsioni 4	<p>Në faqen 186 të Draft-Koncept Dokumentit, përkitazi me këtë opsion, thuhet se “Në rast se vlerësimi i mekanizmit është negativ dhe i njëjti propozon shkarkimin e subjektit, të njëjtit do i ndalohe aplikimi në pozitën e gjyqtarit, prokurorit, kryeprokurorit dhe anëtarit të Këshillave”. Me këtë rast, IKD rekomandon që të shtohet edhe periudha kohore prej 15 viteve pas shkarkimit të subjektit të vetingut. Personat që dështojnë në vetting po ashtu duhet të kenë të kufizuar edhe të drejtën për tu bërë pjesë e ushtrimit të funksionit të avokatisë në Kosovë.</p>	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshin 21.
-----	-----------	--	---------------------	------------------------------

IKD	Opsioni 5	<p>Në faqen 195 të Draft-Koncept Dokumentit janë listuar ndikimet në të drejtat themelore që mund të sjellë procesi i vetingut. Në kuptim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, veçanërisht në raport me opsionin 4 dhe 5, vet Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton një mekanizëm që mbron të drejtat e njeriut edhe me rastin e amendamentimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.</p> <p>Neni 113.9 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”, derisa neni 144.3. i kësaj kushtetute përcakton se “Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk</p>	Pranohet pjesërisht	Është trajtuar mjaftueshëm në Koncept Dokument.
-----	-----------	---	---------------------	---

		<p>pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”. Në këtë mënyrë, përkundër faktit se vetingu sipas opsionin 4 dhe 5 do të bëhet me ndryshime kushtetuese, as vet amandamenti kushtetues nuk mund të pakësoj të drejtat e njeriut dhe lirive themelore. Krahas normave kushtetuese të kapitullit II, rëndësi e posaçme në këtë rast i ipet edhe instrumenteve ndërkombëtare të listuara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.</p> <p>Ky aspekt do të ketë rëndësi veçanërisht me rastin e draftimit të amendamenteve kushtetuese, për të cilën arsye, IKD rekomandon që kjo pjesë e Draft-Koncept Dokumentit të plotësohet edhe me këtë argument.</p>		
--	--	---	--	--

IKD	Opsioni 5	<p>Në figurën 11 të Draft-Koncept Dokumentit është paraqitur plani i zbatimit për opsionin 4. Në aktivitetet 1.3.1-1.3.4 është përcaktuar se në vitin e katërt do të bëhet verifikimi i anëtarëve të KGJK-së, të paktën pesë (5) gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe kandidatëve për anëtarë të KGJK-së. Ndërsa, në aktivitetet 1.3.5-1.3.13 është përcaktuar se gjatë vitit të pestë do të bëhet verifikimi i gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës Supreme, kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme, Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, kandidatëve për Gjyqtar të Gjykatës së Apelit, Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së, administratorëve të Gjykatave, Drejtorit të Njësisë për Inspektim Gjyqësor, kandidatëve të propozuar për gjyqtarë, Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës dhe Gjyqtarëve të Gjykatave Themelore.</p> <p>Përshtatshmërisht, kështu është planifikuar edhe procesi i vetingut të prokurorëve sipas opsionit 4. Po ashtu, në këtë mënyrë është vepruar edhe në raport me vetingun ndaj gjyqtarëve sipas opsionit 5.</p> <p>IKD vlerëson se ky planifikim</p>	Pranohet plotësisht	Shih planet e përditësuara të zbatimit për secilin nga opsionet në Koncept Dokument.
-----	-----------	--	---------------------	--

është disproporcional dhe i pa arsyetueshëm. Sipas këtij planifikimi, i bie se gjatë vitit të katërt do të verifikohet 13 anëtarë të KGJK-së dhe pesë (5) gjyqtarëve të Gjykatës Supreme si dhe kandidatët për anëtarë të KGJK-së. Pra, maksimalisht, sikurse të gjithë anëtarët e KGJK-së moshën kalonin vetë, numri i gjyqtarëve që do të vetohen gjatë vitit të katërt është 31. Ndërsa, pjesa tjetër e gjyqtarëve, është planifikuar që të vetohen gjatë vitit të pestë. Sipas të dhënave të paraqitura në Draft-Koncept Dokument, numri i gjyqtarëve që do të verifikohen gjatë vitit të pestë del të jetë 399. Pra, sipas këtij planifikimi, gjatë vitit të katërt do të vetohen maksimalisht 31 gjyqtarë, ndërsa në vitin e pestë gjithsej 399 gjyqtarë. Disproporcion i kësaj natyre por në vlera tjera, paraqitet edhe tek verifikimi i prokurorëve sipas opsionit 4. Ky planifikim është jo i arsyeshëm, pasi i bie se në vitin e pestë, do të vetohet 12 -fishi i numrit të gjyqtarëve të cilët janë verifikuar në vitin e katërt. Në këtë mënyrë, shpërndarja e aktiviteteve në vite është paarsyeshëm

		<p>disproporcionale.</p> <p>Në rastin e vetingut të prokurorëve sipas opsionit 5, është përcaktuar se në vitin e katërt do të bëhet vetingu ndaj të gjithë anëtarëve të KPK-së dhe të gjithë prokurorëve në sistem, përjashtimisht prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të cilët do të verifikohen në vitin e pestë. Pra, përderisa në vitin e katërt do të bëhet verifikimi i të gjithë prokurorëve, në vitin e pestë do të verifikohen vetëm prokurorët në ZKSh. Edhe në këtë rast, kjo del të jetë disproporcionale.</p> <p>Për këto arsye, IKD rekomandon që të rishikohet plani i zbatimit në atë mënyrë që aktivitetet të shpërndahen proporcionalisht dhe arsyeshëm në vite.</p>		
IKD	Opsioni 5	IKD rekomandon që pjesët kur flitet për masat e trajtimit të detyrueshëm ndaj subjekteve të vetingut të fshihen nga Draft-Koncept Dokumenti.	Pranohet plotësisht	

IKD	Opsioni 5	Kufizimi i subjekteve të vetingut për dorëheqje është shkelje e të drejtave të njeriut dhe është koncept i gabuar dhe pa relevancë praktike. Dorëheqja është akt ekskluzivisht personal. Secili subjekt përmes dorëheqjes shpreh vendimin e tij personal për të mos vazhduar ushtrimin e një detyrë të caktuar. Mohimi i kësaj të drejte paraqet punë të detyruar, e cila është e ndaluar për secilin person. Këtë kufizim, nuk mund të legjitimoj asnjë arsye që ndërlidhet me subjektet që do ti nënshtrohen vetingut. (...) Për këtë arsye, IKD rekomandon që pjesët që flasin për kufizimin e të drejtës së subjekteve të vetingut për dorëheqje të fshihen nga Draft-Koncept Dokumenti.	Pranohet plotësisht	Subjekteve të vetingut duhet t'u lihet e drejta e dorëheqjes gjatë gjithë procesit. Subjektet që japin dorëheqje nuk do të jenë pjesë e procesit të vetingut. Në rast të aplikimit për pozitën e gjyqtarit, prokurorit, kryeprokurorit apo anëtarit të Këshillave, subjekti do të hyjë në proces të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë njëjtë sikurse të gjithë kandidatët për rekrutim.
OSCE	Koment i përgjithshëm	Nuk duket se justifikimet e paraqitura në draft Koncept Dokumentin dëshmojnë nevojën për të kryer një procedurë kaq të jashtëzakonshme.	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 3.

OSCE	Koment i përgjithshëm	<p>Prandaj është thelbësore që Draft Koncept Dokumenti të adresojë në mënyrë adekuate procesin e rregullt, dhe të reflektojë mbi pasojat që masat e propozuara do të kenë mbi të drejtat themelore. Konsiderojmë që Draft Koncept Dokumenti duhet të jep më shumë hollësi rreth garancive që do të zbatohen për t'i mbrojtur këto të drejta dhe veçanërisht mënyrën se si ato garanci do të zbatohen në kontekstin e secilit opcion të propozuar. Ky informacion duhet të sigurohet edhe në pjesët tjera përveç kapitullit mbi "Ndikimet në të drejtat themelore" ku shtjelohet praktika ndërkombëtare.</p>	Pranohet plotësisht	<p>Që nga momenti i inicimit të vetingut, përkatësisht vlersësimi të vazhdueshëm, subjekti do të njoftohet se është duke u trajtuar lëndat e tij. Ligji do të sigurojë respektimin e të drejtës së subjektit në gjykim të drejtë, duke përcaktuar se ai/ajo do të ketë qasje në materialin e lëndës së tij, pra në gjetjet dhe informatat e mbledhura nga Mekanizmat. Subjekti i vetingut do të ketë të drejtë t'i kundërshtojë këto gjetje dhe të paraqesë prova, dhe dëshmitarë, si dhe të marr në pyetje dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër tij apo saj, përpara se Mekanizmi gjegjës të bëjë vlerësimin që do t'i prezantojë Këshillit përkatës. Periudha kohore se kur duhet t'i prezentohen palës provat dhe afati kohor për përgaditjen e përgjigjes, do të përcaktohet me ligj. Pala në procedurë ka të drejtë të kërkojë hedhjen poshtë të provave marrja e të cilave është në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme në procedurën e vetingut, si dhe nëse të njëjtat nuk provojnë ndonjë fakt relevant në procedurë.</p>
------	-----------------------	---	---------------------	---

OSCE	Koment i përgjithshëm	Në opsionet tre deri në pesë, Draft Koncept Dokumenti parasheh “kontroll të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë. Ne konsiderojmë që, nëse zbatohet vetingu, ai duhet të mbetet si masë krejtësisht e jashtëzakonshme, e njëhershme, e përkohshme, e cila nuk do të përdoret në kushte normale.	Pranohet plotësisht	<p>Është larguar termi dhe koncepti "veting periodik". Veting do të ketë vetëm një herë.</p> <p>Sidoqoftë, Opsioni 3, 4 dhe 5 parashohin ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, ashtu që pasi të jetë finalizuar procesi i vetingut, të dy mekanizmat për veting do të ristrukturohet përshtatshëm dhe shndërrohet në mekanizma për vlerësim të vazhdueshëm të integritetit, pasurisë dhe performancës. Anëtarët në kuadër të secilit prej dy mekanizmave do të kenë mandat të caktuar.</p>
OSCE	Koment i përgjithshëm	Konsideroni zgjatjen e afatit për konsultime publike për Draft Koncept Dokumentin në mënyrë që të pranohen komente kuptimplota dhe gjithëpërfshirëse nga të gjitha palët e interesuara	Refuzohet	<p>Konsultimi publik i këtij Koncept Dokumenti është zhvilluar në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik përmes platformës elektronike në kohëzgjatje prej 15 ditësh pune është konsideruar e mjaftueshme, duke marrë parasysh se Grupi Punues ka qenë mjaft i gjerë dhe në komunikim të vazhdueshëm.</p>

OSCE	Koment i përgjithshëm	Konsideroni mundësinë që ta eksploroni më në thellësi përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimin brenda kuadrit ligjor aktual dhe të siguroni një analizë më të plotë të kuadrit ekzistues ligjor	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 3.
OSCE	Koment i përgjithshëm	Sqaroni termin “veting”, në krahasim me termat dhe procedurat e “vlerësimit të performancës”, “kontrolleve të së kaluarës” dhe “proceseve disiplinore”;	Pranohet plotësisht	<p>Koncepti Dokumenti është plotësuar me nën-kapitullin "Sqarime lidhur me termin veting" në Kapitullin e parë. Njëra nga pikat që shpërndahet në paqartësi në lidhje me përmbajtjen e vetingut janë pikërisht keqkuptimet e termit “veting” (në gjuhën angleze “vetting”) dhe ngatërrimi i tij me shumë procese të tjera të ngjashme.</p> <p>Për fillim, duhet theksuar se në gjuhën shqipe mungon një term i barazvlershëm me termin “vetting” në gjuhën angleze. Ky term tashmë është shqipëruar në termin “veting” që përmendet shpesh në diskursin publik. Megjithatë, diskutimet e zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë dhe brenda grupit punues, tregojnë se ka një larmi mendimesh mbi termin dhe përmbajtjen e tij. Prandaj, për qëllime të këtij dokumenti, është e rëndësishme që të bëhet një sqarim i përmbajtjes së këtyre termeve dhe proceseve të ndryshme.</p>

				<p>Kontrollet e të së kaluarës (background checks), të kryera para vetingut ose kontrollit të integritetit, bëhen për ta konfirmuar identitetin dhe konstatuar besueshmërinë dhe integritetin e personit. Ato duhet ta verifikojnë identitetin e subjektit, historikun e punësimit, të drejtën e punës në vend dhe të ekspozojnë ndonjë ndëshkim eventual penal të pavuajtur. Kontrollet e tilla kryhen gati nga të gjithë punonjësit dhe janë një parakusht i nevojshëm për proceset më rigorozë të verifikimit. Kur është e nevojshme, kontrollet e integritetit apo vetingu, përfshijnë një sërë verifikimesh shtesë, përfshirë gjendjen financiare dhe çfarëdo rreziku të cenueshmërisë që shfaqet për shkak të familjes dhe bashkëpunëtorëve. Kontrollet duhet të synohen të jenë në mënyrë proporcionale me vlerësimin e asaj nëse një individ është përfshirë në korrupsion në të kaluarën, aktualisht është i përfshirë në korrupsion, ose me gjasë do të përfshihet në të ardhmen në korrupsion dhe rreziku që ata mund ta</p>
--	--	--	--	---

			<p>paraqesin gjatë kryerjes së detyrave të tyre si rrjedhojë e kësaj përfshirje të tyre në këto afere korruptive.</p> <p>Vlerësimet e performancës dallojnë nga vetingu apo kontrolli i integritetit. Vetingu dhe kontrollet e së kaluarës synojnë adresimin e integritetit dhe cenueshmërive, ndërsa vlerësimet adresojnë kompetencën dhe potencialin. Implikimet e proceseve janë të ndryshme: dështimi i një procesi të verifikimit mund të rezultojë që një kandidat jo kompetent të mos emërohet në një pozitë, mos t'i jepet qasje në materialin e ndjeshëm, ose të mos largohet nga pozita që e mban. Në anën tjetër, pasoja e performancës së dobët në një vlerësim paraqet mos zhvillimin profesional në karrierë.</p> <p>Shpesh kombinohen proceset për kontrollin e integritetit dhe hetimet penale ose administrative. Kontrolli i integritetit dhe hetimi penal iu shërbejnë qëllimeve të ndryshme dhe kanë karakteristika të ndryshme procedurale dhe ligjore. Një hetim bazohet në nevojën për konstatimin nëse diçka ka</p>
--	--	--	---

			<p>ndodhur, ndërsa verifikimet e integritetit shikojnë rrezikun ose gjasën që diçka do të ndodh në të ardhmen. Në mënyrë kritike, barra e provës dhe standardi i provës shpesh do të jenë të ndryshme. Në juridiksionet që zbatojnë të drejtën zakonore, hetimet penale kërkojnë që të konstatojnë provën përtej dyshimit të bazuar ku barra bie mbi shtetin. Në një sistem të vetingut dhe kontrollit të integritetit, mund të jetë tërësisht legjitime të mos vendoset barra mbi shtetin, por në subjektin që i nënshtrohet vetingut - gjyqtarin apo prokurorin që synon ose mban atë pozitë. Standardi i provës shpesh mund të përmbushet në bilancin e gjasave.</p> <p>Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dëshmon për një ngatërrim të këtyre termeve dhe proceseve. Para se të ftohen në intervistë kandidatët që e kanë kaluar testin me shkrim, ata i nënshtrohen vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale. Rezultatet e këtij vlerësimi, të shprehura në numra apo pikë, pastaj llogariten kumulativisht në kuadër të</p>
--	--	--	--

			<p>rezultatit të përgjithshëm të intervistës. Ky proces duket të jetë një përzierje e kontrollit të të kaluarës, e që duhet të jetë pjesë e procesit të verifikimit të ndërmarrë vetëm pas përfundimit të procesit të rekrutimit apo miratimit të përzgjedhjes në parim, bazuar në cilësitë, aftësitë dhe shkathtësitë e kandidatit.</p> <p>Marrë parasysh që kontrollet e duhura të së kaluarës në fazën e duhur për emërimin e gjyqtarëve janë një hap thelbësor në luftën kundër korrupsionit, është shumë me rëndësi që këto dy vlerësime të ndryshme të ndahen njëra nga tjetra. Kontrollet e të së kaluarës nuk duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të aftësisë së kandidatit që të jetë gjyqtar, por duhet të trajtohen veçmas dhe në një mënyrë sistematike dhe më rigoroze.</p> <p>Vetingu, si formë e kontrollit të integritetit, vlerëson rrezikun ndaj një objekti të përcaktuar dhe parametrat operacional të përcaktuar nga vetë ky objektivi. Në këtë dokument, ky rrezik trajtohet nga perspektiva e përmirësimit të</p>
--	--	--	---

			<p>transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, së bashku me besimin që qytetarët kanë në të.</p> <p>Hulumtimi për këtë koncept dokument tregon që rreziku i cili kërkohet të mënjanohet është ndjeshmëria e një individi ndaj korrupsionit. Të gjitha proceset që vijnë, pra, duhet të synojnë të vlerësojnë besueshmërinë, integritetin dhe kredibilitetin e anëtarëve të sistemit gjyqësor e prokurorial.</p> <p>Qëllimi i vetingut sipas kësaj politike nuk është ndëshkimi sipas dispozitave të Kodit Penal, në përputhje me procedurën dhe masat mbrojtëse të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, apo njollosja ose hakmarrja ndaj anëtarëve të sistemit të drejtësisë. Qëllimi në fakt është mbrojtja e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe anëtarëve tjerë me integritet në sistemin e drejtësisë nga ndikimet dhe sigurimi i mundësisë për ta që të marrin vendime të drejta dhe të bazuara në ligj.</p>
--	--	--	---

OSCE	Opsioni 3	<p>Shmangni gjuhën dhe kriteret e paqarta për largimin e gjyqtarëve nga detyra për të shmangur ndërhyrjen në punën e tyre dhe për t'i saktësuar kriteret e sakta për vlerësim</p> <p>Opsioni III parashikon shkarkimin e gjyqtarëve në rast të “kryerjes së një vepre të rëndë penale dhe neglizhencës serioze të detyrave nga gjyqtarët dhe prokurorët”. Por, duhet të theksohet, sipas Ligjit aktual për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarët dhe Prokurorët kjo sjellje veçse rezulton me shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve e që është në përputhje me standardet ndërkombëtare.</p> <p>Prandaj, propozimi bën thirrje për të vlerësuar nëse ekzistojnë bazat për fillimin e procedurave disiplinore, të cilat mund të çojnë në sanksione, shkarkim ose akuza penale, edhe në rrethana normale, pavarësisht mekanizmave të vetingut.</p>	Pranohet plotësisht	<p>Sipas Opsionit 3, shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve do mund të bëhet vetëm për dy arsye: kryerja e veprës së rëndë penale si dhe mosrespektimi i rëndë i detyrave nga gjyqtarët dhe prokurorët. Arsyet për shkarkim mbi bazën e një vlerësimi negativ në procesin e vetingut, do të detajizohen me ligj. Megjithatë në kontekstin e analizës në këtë Koncept Dokument, shkarkimi, që mund të rezultojë si kërkesë nga procesi i vetingut apo vlerësimit të vazhdueshëm, duhet futur nën ombrellën e arsyes për shkarkim - mosrespektim i rëndë i detyrave.</p> <p>Dispozitat kushtetuese që flasin për arsyet e shkarkimit të gjyqtarëve duket se duhet lexuar paralelisht me përcaktimet kushtetuese rreth mandatit të gjyqtarëve. Si të tilla, lënë hapësirë që “mosrespektimi i rëndë i detyrave” si shkak për shkarkim të gjyqtarëve të definohet me ligj. E njëjta vlen dhe sa i përket prokurorëve.</p> <p>Ndonëse në kuptimin e ngushtë mund të mendohet se kjo bazë shkarkimi nuk</p>
------	-----------	---	---------------------	---

				mund të akomodojë çështjen e vlerësimit të integritetit si pikësnyim i vetingut, duhet rikujtuar se kjo në një mënyrë veçse zbatohet për momentin. Me kornizën ekzistuese ligjore, integriteti personal është i përfshirë në kuadër të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Prandaj koncepti i vlerësimit të integritetit edhe gjatë ushtrimit të detyrës nuk është i panjohur. Megjithatë, nuk është e qartë se si vlerësohet ai në praktikë.
OSCE	Koment i përgjithshëm	Duhet të saktësohet se aspektet që kanë të bëjnë me përmbajtjen e vendimeve gjyqësore nuk bien kurrë në fushëveprim të vetingut, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë ose kur ka një trend të qartë dhe konsistent të aktgjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të qartë profesionalizmi.	Pranohet plotësisht	

OSCE	Koment i përgjithshëm	Sigurohuni që Draft Koncept Dokumenti të përcaktojë qartë përzgjedhjen e anëtarëve të mekanizmit dhe organizatave ndërkombëtare të përfshira	Pranohet plotësisht	<p>Duhet rikujtuar se bazuar në përcaktimet kushtetuese, anëtarët e këtyre mekanizmave do të zgjedhen nga Këshillat përkatës (KGJK/KPK). Në këtë drejtim, për të siguruar cilësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e mekanizmave, parashihet që procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të tyre të jetë transparent dhe rigoroz. Është e rëndësishme që me rastin e rekrutimit, të ketë një përfshirje të akterëve jashtë strukturave aktuale gjyqësore dhe prokuroriale. Kjo pasi, në fazën kur duhet përzgjedhur anëtarët e secilit prej mekanizmave, përfshirë stafin në Sekretariat dhe panele, anëtarët e Këshillave nuk do të jenë të vetuar.</p> <p>Procedura përmes së cilës parashihet të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të mekanizmave, ndonëse do të nisët me konkurs dhe përfundohet nga vetë Këshillat, do të ketë përfshirje të madhe të mekanizmave gjegjë ndërkombëtarë. Këshillat do të mund të kontraktojnë apo të bëjnë marrëveshje mirëkuptimi me trupa apo organizata ndërkombëtare për të kërkuar ndihmën e</p>
------	-----------------------	--	---------------------	---

			<p>tyre në përzgjedhjen, përfshirë vlerifikimin, e anëtarëve të mekanizmave respektiv. Një model i ngjashëm me këtë mund të shihet aktualisht në Kosovë në modalitetet e gjetura për përzgjedhjen e Pozitave të Larta Drejtuese, procedura këto në të cilat intervistimi dhe rekomandimi vie nga trupa me përbërje ndërkombëtare (shembull me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë). Pjesëmarrje monitorues do të kërkohet nga partnerët ndërkombëtarë edhe përgjatë gjithë periudhës sa zgjatë vetingu.</p> <p>Pas përfundimit të procesit verifikues, do të dilet me rekomandimin për emrat të cilët propozohet që të zgjedhen nga Këshillat për të qenë anëtarë të mekanizmave. Emrat e personave të rekomanduar për t'u zgjedhur duhet të jenë publik, bashkë me arsyetimet për rekomandimin e tyre.</p> <p>Megjithatë, ritheksohet se vendimi final për zgjedhjen e tyre si anëtarë të mekanizmave, merret nga vetë Këshilli përkatës. KGJK/KPK mund të refuzojnë</p>
--	--	--	--

				emërimin apo përzgjedhjen e një apo më shumë të rekomanduarve, por duhet të arsyetojnë vendimin e vet për këtë, pavarësisht asaj se a do të përcaktohet që votimi të jetë i fshehtë apo publik. Në rast të refuzimit të ndonjë anëtari, rekomandohet një kandidat tjetër i verifikuar.
OSCE	Opsioni 3	Meqë Këshillat përkatës do t'i zgjedhin anëtarët e këtyre mekanizmave, kjo mund të rezultojë të jetë problematike, veçanërisht duke marrë parasysh që në fillim vetë anëtarët e Këshillave nuk do të kalojnë në veting, që do të thotë se ata do të vlerësojnë njerëz që më pas do t'i vlerësojnë ata.	Pranohet pjesërisht	Duhet të theksohet se analiza e zhvilluar në Opsionin 3, parasheh zhvillimin e vetingut dhe vlerësimit të vazhdueshëm të performancës, integritetit dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë në përputhje me kornizat dhe rrjedhimisht kufizimet që i përcakton Kushtetuta. Si rrjedhojë, është e pamundur që cfarëdo ndërhyrje vetëm përmes ndryshimit të legjislacionit, të anashkalojë kompetencat kushtetuese të Këshillave.

			<p>Sistemi është modeluar në frymën e ndarjes së pushteteve që përcakton Kushtetuta. Vendimmarrja përfundimtare ju është lënë këtyre organeve, pikërisht për shkak të përcaktimeve kushtetuese. Procedura e hapur dhe e monitoruar ndërkombëtarisht sigurojn kredibilitetin dhe integritetin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të mekanizmave përkatës dhe njëkohësisht, ruan ndarjen e pushteteve.</p> <p>Është thelbësore ndërmarrja e procesit të verifikimit për kandidatët për anëtarë të mekanizmave, kjo pasi që ata që bëjnë vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet vetë të jenë subjekte të verifikuar në mënyrë. Kështu, ofrohet garanci që procesi nuk do të jetë i cënueshëm në dëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen vetingut.</p> <p>Nga ana tjetër, procedura e hapur dhe e monitoruar ndërkombëtarisht, si dhe verifikimi nga jashtë sistemit i dy mekanizmave, janë faktorët kryesorë për të ruajtur procesin nga brenga potenciale për konflikt të interesit, i cili mund të vie për shkak të rolit të KGJK-së,</p>
--	--	--	--

				gjegjësisht KPK-së në emërimin përfundimtar të anëtarëve.
OSCE	Opsioni 3	Në lidhje me përbërjen e “mekanizmit të ri”, Opsioni III propozon “valë” të vetingut që do të përfshinin anëtarët e organizatave ndërkombëtare në “mekanizmat e rinj”. Kjo propozohet në Draft Koncept Dokument si masë për të siguruar paanshmëri dhe mund të shërbejë në të vërtetë për të rritur besueshmërinë. Por, meqenëse lloji i sistemit hibrid të propozuar nga Opsioni III përfshin veting të vazhdueshëm (jo akt i jashtëzakonshëm e i njëhershëm, që në vete ngre shqetësime serioze), është e vështirë të shihet roli i organizatave të jashtme ndërkombëtare në një afat më të gjatë.	Pranohet pjesërisht	Një model i ngjashëm me këtë mund të shihet aktualisht në Kosovë në modalitetet e gjetura për përzgjedhjen e Pozitave të Larta Drejtuese, procedura këto në të cilat intervistimi dhe rekomandimi vie nga trupa me përbërje ndërkombëtare (shembull me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë). Pjesëmarrje monitorues do të kërkohet nga partnerët ndërkombëtarë edhe përgjatë gjithë periudhës sa zgjatë vetingu. Drejt detajeve do të punohet në vazhdimësi, gjatë hartimit të ligjit.

OSCE	Opsioni 2/Opsioni 3	Për më tepër, sipas draftit, mekanizmat e rinj nuk japin vendime detyruese, por vetëm “vlerësime” mbi cilësinë e performancës së gjyqtarëve/prokurorëve. Prandaj, shtrohet pyetja se si ata me të vërtetë do të bëjnë një “punë më të mirë” sesa mekanizmat që i zëvendësojnë dhe nëse zgjidhje më e mirë do të ishte të mos kërkoheshin ndryshime të thella ligjore, por të përmirësohen mjetet dhe mekanizmat ekzistues.	Pranohet pjesërisht	Shih sqarimin në rreshtin 61 dhe sqarimin në rreshtin 3.
OSCE	Koment i përgjithshëm	Sigurohuni që kontrollet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të mos kalojnë përtej kontrolleve standarde të të dhënave penale dhe arsyeve të skualifikimit nga policia. Asnjë kontroll tjetër i së kaluarës nuk duhet të kryhet nga shërbimet e sigurisë.	Pranohet plotësisht	
OSCE	Koment i përgjithshëm	Përveç kësaj, nëse ka kontrolle të së kaluarës, është me rëndësi që rezultatet të ofrohen në dispozicion për aplikuesin, i cili duhet të ketë të drejtë ta apelojë konstatimin.	Pranohet plotësisht	Shih sqarimin në rreshtin 53.
OSCE	Koment i përgjithshëm	Të sqarohet kuptimi i raporteve “konfidenciale” dhe “gjysmë-konfidenciale” në mënyrë që të mos minohet transparenca dhe besueshmëria e procesit.	Pranohet plotësisht	

OSCE	Koment i përgjithshëm	Të sigurohet që ruajtja e informacionit të lidhur me shëndetin të jetë në përputhje me të drejtën për privatësi dhe jetë familjare.	Pranohet plotësisht	Shih sqarimin në rreshtin 44.
OSCE	Opsioni 4	Elaborimi i mënyrës së emërimit, përbërjes dhe autorizimeve vendimmarrëse të këtij organi të ri kushtetues në mënyrë që të kuptohet më mirë se si një pavarësi e tillë do të arrihej në praktikë	Pranohet plotësisht	Shih sqarimin në rreshtin 15.
OSCE	Opsioni 4	Opsioni IV, ndryshe nga opsioni III, duket se ofron një zgjidhje më të favorshme sesa zgjedhja e anëtarëve të paneleve nga KGJK dhe KPK, të cilët edhe vetë së shpejti do t'i nënshtrohen vetingut. Në të njëjtën kohë, fakti që Presidenti merr pjesë në përzgjedhjen e anëtarëve të paneleve dhe më pas vendos nëse do të veprojnë sipas vlerësimeve dhe propozimeve të tyre për shkarkimin e një gjyqtari/prokurori, hedh dyshime për vetë transparencën e kësaj procedure dhe krijon hapësirë për ndikim politik. Prandaj, ne rekomandojmë që një organ i përhershëm siç është një gjykatë ose këshilli gjyqësor të luajë një rol vendimtar në marrjen e vendimit. Në çdo rast,	Refuzohet	Ky model është paraparë në frymën e ndarjes së pushteteve dhe kompetencave tipike përkatëse të secilit institucion për një demokraci parlamentare, sic është Kosova. Më tutje, duhet të rregullohen kompetencat e Presidentit për emërim, riemërim dhe shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto kompetenca duhet të jenë kryesisht formale, por të krijojnë siguri dhe legjitimitet të procesit të vetingut. Pra, shkarkimi i subjektit vendoset në bashkëpunim në mes të mekanizmit dhe Presidentit, për të siguruar po ashtu kontrollin dhe balancin e procesit.

		<p>mënyra e emërimit, përbërja dhe autorizimet vendimmarrëse të këtij organi të ri kushtetues (mekanizmi të pavarur të vetingut) do të përfitonin nga elaborimi për të kuptuar më mirë, se si një pavarësi e tillë do të arrihej në praktikë.</p>		
OSCE	Opsioni 4	<p>Të rishikohen bazat për shkarkimin e një gjyqtari, ose nëse bazat do të ndryshojnë, atëherë ato duhet të përmbajnë arsyet e sakta dhe të detajuara të shkarkimit. Sipas draft-koncept dokumentit, me ndryshimin e Kushtetutës, një arsye shtesë për shkarkimin do të shtohet në Opsionin IV, domethënë, rezultati negativ në procesin e vetingut. Siç është formuluar nga Draft Koncepti, kjo do të thoshte se, “subjekti [i vetingut] që nuk e kalon procesin e verifikimit”. Problemi me këtë formulim është se është i gjerë dhe mund të përfshijë një numër kriteresh ende të pacaktuara për vetingun. Komisioni i Venecias ka</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Për të krijuar siguri juridike, neni 104 (4) dhe 109 (6) duhet plotësuar. Këto dy dispozita përcaktojnë dy arsye për shkarkim të gjyqtarit apo prokurorit, të cilat janë vepra e rëndë penale dhe mosrespektimi i rëndë i detyrave. Me ndryshim të Kushtetutës parashihet zgjerimi i bazës për shkarkim të subjekteve të vetingut, duke shtuar edhe një arsye për shkarkim, që ndërlidhet me të gjeturat e vetingut, atëherë kur plotësohen kushtet për shkarkim të subjektit. Arsyet e detajuara për shkarkim mbi bazën e një vlerësimi negativ në procesin e vetingut, do të parashihen me ligjin përkatës për vetingun.</p>

		<p>deklaruar më parë se si rregull, kriteret për papërshtatshmërinë ose humbjen e një mandati duhet të jenë të sakta dhe të zbatueshme pa një marginë të gjerë vlerësimi, në mënyrë që të garantohet zbatimi i ligjit në mënyrë të barabartë dhe transparente. Lidhja e shkarkimit të gjyqtarit me kalimin e suksesshëm ose të pasuksesshëm të procedurës së vetingut nuk do të përbënte arsye të sakta, të drejta dhe të arsyeshme (për shkarkim). Prandaj, ne rekomandojmë që nuk ka nevojë të ndryshohen bazat e shkarkimit, ose nëse ato duhet të ndryshojnë, atëherë ato duhet të përmbajnë arsyet e sakta dhe të detajuara për shkarkimin e një gjyqtari me procedurën e vetingut.</p>		
--	--	--	--	--

OSCE	Opsioni 4	<p>Procedura e vetingut e propozuar në Opsionin IV është e obligueshme. Refuzimi për të bashkëpunuar me procesin e vetingut do të rezultojë në shkarkimin dhe përjashtimin e një individi nga profesioni për 15 vjet dhe madje edhe atëherë kur kalon një kohë e tillë dhe ata dëshirojnë të kthehen në punën e tyre, ata ende duhet të kalojnë nëpër procedurën e vetingut. Meqenëse natyra dhe masa e bashkëpunimit me panelet përkatëse i nënshtrohet fushëveprimit të tyre, ne sugjerojmë që kriteret për bashkëpunim të përcaktohen qartë në rregulloret ose legjislacionin përkatës. Procedura gjithashtu duhet të jetë e parashikueshme dhe të marrë parasysh rrethanat kur një bashkëpunim i tillë (përkohësisht) nuk është i mundur. Procedura duhet të jetë e drejtë dhe transparente dhe, për shkak të ashpërsisë së sanksionit (shkarkimit), duhet të përmbushen garancitë e procedurës penale dhe disiplinore.</p>	Pranohet pjesërisht	<p>Vetingu është një proces i cili kërkon koordinim ndër-institucional si dhe bashkëpunim të subjekteve të vetingut. Çdo formë e refuzimit të bashkëpunimit të subjektit për t'iu nënshtruar vetingut do ketë pasojë shkarkimin nga pozita si dhe ndalimin për të aplikuar në pozitën e gjyqtarit, prokurorit, kryeprokurorit dhe anëtarit të Këshillave, si dhe do të shqyrtohet ndalimi i funksioneve të caktuara publike. Detajet do të përcaktohen në ligjin përkatës për vetingun.</p>
------	-----------	---	---------------------	---

OSCE	Opsioni 4	Të sigurohet që vetë procedura e vetingut duhet t'i nënshtrohet rishikimit dhe ankesës dhe nuk duhet të përdoret si mjet presioni ndaj gjyqtarëve për t'iu nënshtruar vetingut ose dorëheqjes/pranimi të pensionit të parakohshëm	Pranohet plotësisht	
OSCE	Opsioni 4	Opsioni IV paraqet dy skenarë të ndryshëm: (1) gjyqtarët, të cilët nuk pranojnë t'iu nënshtrohen vetingut, duhet të japin dorëheqje jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të mekanizmit të vetingut dhe 2) gjyqtarët që japin dorëheqje do të ndalohen të aplikojnë për poste të caktuara. Në vërejmë se periudha tre mujore për dorëheqjen duket të jetë vetëm për efektshmërinë e proceseve të vetingut. Megjithatë, gjyqtarët mund të vendosin të japin dorëheqje në vend se të jenë pjesë e procedurës së vetingut për arsye të ndryshme, të cilat mund të përfshijnë perceptimin e publikut për mungesën e pretenduar të aftësisë dhe mungesën e pretenduar të integritetit, por gjithashtu, për arsye të tjera, si perceptimi i procesit si mjet politik, shëndeti aktual i gjyqtarit etj. Prandaj, disa	Pranohet pjesërisht	<p>Nga Koncept Dokumenti është larguar çfarëdo kufizimi i të drejtës për dorëheqje. Gjatë zhvillimit të vetingut, kandidatët kanë të drejtën e dorëheqjes në çdo moment. Në rast se subjekti aplikon në të ardhmen për pozitën e gjyqtarit apo prokurorit, subjekti do të hyjë në proces të vlerësimit të aftësive profesionale, integritetit dhe pasurisë njëjtë sikurse të gjithë kandidatët për rekrutim.</p> <p>Pasojat e mos-kalimit të procesit të vetingut - Në rast se vlerësimi i mekanizmit është negativ dhe i njëjti propozon shkarkimin e subjektit, të njëjtit do t'iu ndalohet aplikimi në pozitën e gjyqtarit, prokurorit, kryeprokurorit dhe anëtarit të Këshillave.</p> <p>Refuzimi i subjektit për t'iu nënshtruar vetingut - Vetingu është një proces i cili kërkon koordinim ndër-institucional</p>

		gjqtarë, të cilët mund të jenë aftë dhe potencialisht do të kalonin procesin e vetingut, mund të refuzojnë të marrin pjesë në procesin e vetingut me pasojë që atyre do t'u ndalohej të aplikojnë për gjyqtar për 15 vitet e ardhshme.		si dhe bashkëpunim të subjekteve të vetingut. Refuzimi i bashkëpunimit të subjektit për t'iu nënshtruar vetingut do ketë pasojë shkarkimin nga pozita si dhe ndalimin për të aplikuar në pozitën e gjyqtarit, prokurorit.
OSCE	Opsioni 4	Të merret parasysh zgjerimi i përbërjes së paneleve duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve që gëzojnë perceptim të mirë publik, si Avokati i Popullit, përfaqësues të odës së avokatëve të zgjedhur nga oda e avokatëve, anëtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit, shoqërisë civile etj.	Pranohet pjesërisht	Mekanizmit të Vetëingut do të ketë në përbërje edhe anëtarë jo-gjyqtarë, përkatësisht jo-prokurorë. Mekanizmi do të përbëhet nga pesë panele, tre për gjyqtarë dhe dy për prokurorë. Panelet për gjyqtarë do të përbëhen nga tre anëtar, dy gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar. Panelet për prokurorë do të përbëhen nga tre anëtar, dy prokurorë dhe një anëtar joprokuror.
OSCE	Opsioni 5	Opsioni V është trajtuar shumë shkurt në draftin e koncept dokumentit. Nga të dhënat e ofruara, ne konsiderojmë se kompleksiteti i këtij opsioni kërkon shqyrtim më të thukët. Prandaj, për të	Pranohet plotësisht	Kapitulli mbi Opsionin 5 është zgjeruar dhe paraqet një elaborim të detajuar dhe të thelluar.

		mundësuar kuptimin e duhur të opsionit në fjalë, ne sugjerojmë që hartuesit të përkufizojnë më konkretisht mënyrën e kombinimit të Opsionit IV dhe Opsionit III.		
--	--	--	--	--